



RAPORT

**MONITORIM MBI ZBATIMIN E LIGJIT NR.47/2018 PER DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË
MARRËDHËNIET FAMILJARE”,
TË NDRYSHUAR.**

Periudha e Monitorimit: Janar 2019-Dhjetor 2020

Tiranë, Gusht 2021



*Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci
të Ambasadës së SHBA në Tiranë.*

Ky raport monitorimi është realizuar si pjesë e projektit “Të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të përgjigjes ndaj dhunës në familje”.

Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë te autor-it/ve dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Tiranë, Gusht, 2021

Përgatitën: Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi, Av. Aurela Bozo, Rosalyn S. Park¹

Me bashkëpunimin e spikatur të monitoruesve: Lirie Dina, Erisa Vora, Redona Copa, Emi Rrudha, Klea Cahani, Nadia Cobo, Tonin Marku, Eralda Gurra dhe Ina Banushi, vullnetarë të skuadrës *Pro Bono* pranë QNL-së.

¹ Rosalyn S. Park, Director, Women’s Human Rights Program, The Advocates for Human Rights

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Table of Contents

PËRMBAJTJA E LËNDËS	4
LISTA E SHKURTIMEVE	7
HYRJE. QËLLIMI DHE OBJEKTI I MONITORIMIT	8
METODOLOGJIA	8
Veprimtaritë.	9
KUFIZIME E SFIDA TË MONITORIMIT	10
I. VLERËSIMI I RISKUT.	11
1. Performanca e ndryshimeve ligjore nr. 47/2018.....	11
Konkluzion:	12
2. Përvoja pozitive për vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e rastit	12
3. Unifikimi i praktikës mbi bazën përvojave pozitive	14
Përgatitja e dokumentacionit për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM-së.....	14
Kryerja e vlerësimit të riskut dhe faktorët që kanë penguar kryerjen e tij në çdo rast	15
Konkluzion:	17
4. Burimet e informacionit të përdorura nga Policia në vlerësimin e riskut	17
Konkluzion:	18
5. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me KVDHF/Punonjësit socialë përgjatë vlerësimit të riskut.....	18
Konkluzion.	22
6. Bashkëpunimi Polici-NJMF/PMF për vlerësimin e riskut.....	22
Konkluzion:	23
II. Lëshimi i UMPMM dhe zbatimi i tij.	24
1. Lëshimi i UMPMM.....	24

2.	Procedurat për zbatimin e UMPMM-së deri në vendimin e Gjykatës.....	25
	Konkluzion:	26
III.	Zbatimi i vendimeve gjyqësore për UM, UMM.	27
1.	Veprimtaria e policisë së Shtetit.	27
2.	Monitorimi i zbatimit të UM nga KVDHF.	28
	Konkluzion:	29
IV.	SFIDA DHE PROBLEME TË IDENTIFIKUARA NË NIVEL TEKNIK NË TË TRIA BASHKITË.....	29
	TIRANË	29
	Policia e Shtetit.....	29
	Bashkia	30
	DURRËS.....	30
	Policia e shtetit.....	30
	Bashkia	31
	SHKODËR.....	32
	Policia e shtetit.....	32
	Bashkia	32
V.	REKOMANDIME.....	33
1.	Në lidhje me zbatimin e legjislacionit kundër dhunës në familje:.....	33
2.	Në lidhje me veprimtarinë e Policisë së Shtetit.	33
3.	Në lidhje me veprimtarinë e organeve vendore;	34
4.	Në lidhje me sfidat teknike.	35
5.	Të tjera	36
	Anex 1. SKEDA E MONITORIMIT	37

LISTA E SHKURTIMEVE

BGJ	Barazi Gjinore
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DHF	Dhunë në marrëdhënie familjare
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar i Mekanizmit Vendor kundër Dhunës në Familje.
KVDHF	Koordinatori Vendor kundër Dhunës në Familje
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
NSPZ	Ndihmës Specialist i Policimit në Komunitet
NJA	Njesi Administrative
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki
OPGJ	Oficer i Policisë Gjyqësore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
SDHF	Specialist i Dhunës në Familje
SPZ	Specialist i Policimit në Komunitet
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje
UMPMM	<i>Urdhri</i> për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme

HYRJE. QËLLIMI DHE OBJEKTI I MONITORIMIT

Ligji nr.4/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar², solli disa institute të rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje. Zbatimi i tyre u bë objekt i këtij monitorimi, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë tek veprimtaria e Policisë së Shtetit dhe organeve vendore, si institucione përgjegjëse për vlerësimin e riskut, lëshimin e UMPMM dhe monitorimin e urdhrave të mbrojtjes.

Monitorimi është fokusuar në periudhën Janar 2019- Dhjetor 2020, në Tiranë, Durrës dhe Shkodër. Institucionet objekt të monitorimit kanë qenë kryesisht, organet përgjegjëse në Policinë e Shtetit, koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje dhe institucione të tjera përbërëse të mekanizmit të referimit pranë këtyre bashkive.

Qëllimi ynë është që nëpërmjet monitorimit dhe sintetizimit të gjetjeve të monitorimit si dhe diskutimit të tyre, të kontribuojmë në përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj rasteve të dhunës në familje, me qëllim parandalimin dhe ndalimin e saj. Monitorimi ka synuar jo vetëm evidentimin e problematikave në zbatimin në praktikë të ndryshimeve ligjore të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, por edhe evidentimin e praktikave dhe përvojave të mira, me qëllim nxjerrjen e mësimave dhe përhapjen e tyre.

METODOLOGJIA

Metodologjia u përzgjedh në konsultim me partnerin tonë në zbatimin e këtij projekti, Organizatën “Avokatët për të drejtat e njeriut”, me qëllim që të shërbente sa më mirë për të realizuar qëllimin dhe objektin e këtij monitorimi, si dhe për rritjen e ndikimit të gjetjeve të tij. Pranë QNL-së u krijua grupi i ekspertëve nga të dyja organizatat, i cili përcaktoi të gjitha objektivat kryesore dhe metodologjinë e punës që do të kryhej për realizimin e monitorimit. Metodologjia e përzgjedhur ka kombinuar metoda sasiore dhe cilësore. Puna filloi me konsultimet paraprake dhe kërkesat për bashkëpunim me të gjitha institucionet, veprimtaria e të cilëve do të ishte objekt monitorimi. Në këtë fazë u vendosën kriteret e mbështetjes dhe bashkëpunimit midis Qendrës sonë dhe “The Advocates for Human Rights” nga njëra anë, me bashkitë Durrës, Tiranë, Shkodër dhe Drejtorinë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ndërtimi i këtij bashkëpunimi ishte shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e të gjithë monitorimit, por edhe

² Shih: Ligji nr.4/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, i gjindshëm në:

<http://www.parlament.al/Files/Akte/ligj%20nr.%2047.%20dt.%2023.7.2018.pdf>

të të gjitha objektivave të projektit. Për më tepër, monitorimi solli edhe përfitime të tjera. Përmes dispozitave, këto procedura u diskutuan në mënyrë të thelluar. Policia dhe koordinatorët vendorë konfirmuan se ata përfituan shumë nga intervistat dhe diskutimet e organizuara.

Grupi i ekspertëve fillimisht, përgatiti një skedë monitorimi, e cila u konsultua me grupet e punës.

Skeda e monitorimit u organizua në katër seksione:

1. intervistë me punonjës të policisë;
2. monitorimi i raporteve të vlerësimit të riskut dhe vendimeve të UMPMM;
3. monitorimi i raporteve të vlerësimit të riskut dhe vendimeve për urdhrat e mbrojtjes;
4. intervistë me KVDHF, dhe ose punonjës të tjerë.

QNL përzgjedhi një grup monitoruesish dhe ndau detyrat për kryerjen e monitorimit në Tiranë, Durrës dhe Shkodër, sipas seksioneve më sipër.

Veprimtaritë. Për të realizuar këtë raport monitorimi janë kryer veprimtaritë që vijojnë. Janë kryer gjithsej 35 intervista me punonjësit. Nga këto, 27 intervista janë realizuar me punonjës të policisë së shtetit në të tria rrethet; 5 intervista janë realizuar me koordinatorët vendorë, SDHF & BGJ dhe specialistë në rolin e KVDHF në të tria bashkitë; 3 intervista të tjera janë realizuar me specialistë për mbrojtjen e fëmijëve dhe specialistë të tjerë.

Këto të dhëna i kemi përmbledhur në tabelën që vijon në fund të faqes, e cila paraqet intervistat e specialistëve sipas rretheve, si dhe gjininë e të intervistuarve³. E shënuam edhe gjininë, pasi na

³ Paraqitja e të intervistuarve

	KVDHF	PMF	SDHF & BGJ	Specialistë të tjerë në rolin e KVDHF	SPZ /NSPZ	Specialist i dhunës në familje	Total
Tiranë	2	2			14		18
Gjinia	2 F	2 F			13 M & F		
Durrës	1	1	1		5		8
Gjinia	1 F	1 F	1 F		5 M		
Shkodër				1	7	1	9
Gjinia				1 F	7 M	1 F	
Totali	3	3	1	1	26	1	35

dukej e dobishme për të krijuar një perceptim mbi balancat gjinore të pjesëmarrjes në këto mekanizma të rëndësishëm për luftimin dhunës në familje.

Gjetjet nga monitorimi dhe intervistimet janë diskutuar në tri tryeza diskutimi që synuan të rrisin përgjegjshmërinë e institucioneve përgjegjëse për më shumë vëmendje në përmbushjen e përgjegjësive individuale për zbatimin e ligjit. Tryezat e diskutimit janë zhvilluar duke kombinuar ndjekjen online dhe diskutimin ballë për ballë.

Të gjitha gjetjet nga monitorimet e diskutuara dhe të analizuara si më sipër, ishin burim për hartimin e këtij raporti dhe konkluzioneve të tij. Përveç tyre, si burime kanë shërbyer edhe raporte të mëparshme të kryera nga organizata jonë, si dhe nga organizata të tjera simotra. Kështu p.sh., raportet e monitorimit të aktivitetit të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje të kryera nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” janë përdorur si burim informacioni për të konfirmuar gjetjet tona. Të gjitha burimet e raportit janë referuar në përmbajtjen dhe bibliografinë e tij.

Raporti hartohet duke pasur në vëmendje arritjet dhe problemet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, pa pasur qëllim të trajtojë hollësisht diferencat që kanë të tria rrethet midis tyre.

KUFIZIME E SFIDA TË MONITORIMIT

Hartimi i këtij raporti hasi edhe në disa kufizime.

Së pari, edhe pse monitorimi i zbatimit të ligjit është shtrirë në dy vjet, më shumë përvoja u gjetën përgjatë vitit 2020, pasi viti 2019 shërbeu më tepër për njohjen me ndryshimet dhe për rritjen e kapaciteteve të punonjësve. Madje, në disa raste personat përgjegjës të intervistuar pohojnë se progresi në zbatimin e këtyre ndryshimeve është arritur vetëm këtë vit, pra 2021.

Së dyti, nga intervistat kanë rezultuar edhe thënie kontradiktore të cilat nuk janë në përputhje me thënie të mëparshme të të intervistuarve të tjerë.

Së katërti, një nga kufizimet rezultoi gjatë monitorimit, pasi disa punonjës policie të intervistuar nuk kishin përvoja në zbatimin e ndryshimeve të ligjit kundër dhunës në familje të vitit 2018.

Së pesti, një kufizim që vështirësoi punën ishte pandemia Covid-19. Kjo ngadalësoi kontaktet tona me punonjësit dhe reduktoi rrethin e të ftuarve me prezencë për diskutimet e rezultateve.

I. VLERËSIMI I RISKUT.

1. Performanca e ndryshimeve ligjore nr. 47/2018

Punonjësit e policisë, shprehen se ndryshimet ligjore në lidhje me vlerësimin e riskut dhe UMPMM u kanë lehtësuar punën, sepse tashmë ata kanë një bazë ligjore që i lejon të marrin në mbrojtje viktimën menjëherë në momentin e denoncimit të dhunës në familje. Në të shkuarën, policia dhe institucionet e tjera prisnin që gjykata të lëshonte Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes. Të intervistuar në qarkun Durrës, Tiranë, e Shkodër punonjësit e policisë theksojnë se, vlerësimi i riskut ka ndikuar pozitivisht në ndërhyrjen sa më të shpejtë për parandalimin e përshkallëzimit të dhunës në familje dhe agravimit të situatës. Më parë policia merrte denoncimin për dhunë në familje, bënte kërkesën për UMM/UM dhe priste deri në lëshimin e UMM/UM me vendimin e gjykatës (48 orë ose 15 ditë) për caktimin e masave nga gjykata. Gjatë kësaj periudhe nuk e kishte të qartë se çfarë të bënte me viktimën dhe dhunuesin.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore të vitit 2018 policia kryen vlerësimin e riskut dhe urdhëron lëshimin e UMPMM-së me masa mbrojtëse që garantojnë sigurinë e viktimës. Nga monitorimi rezultoi se një progres i qartë i vlerësimit të riskut dhe lëshimit të UMPMM-së, është shënuar vetëm në vitin 2020-2021, thuajse dy vjet pasi ndryshimet ligjore hynë fuqi. Në gjykojmë se kjo periudhë tregon ngadalësi të institucioneve. Shkak për këtë ngadalësi është bërë nevoja për përgatitjen e strukturave me ndryshimet ligjore. Sidoqoftë, përvojat më të hershme nuk kanë munguar sidomos në policinë Tiranë, më tej në Durrës, ndërkohë që në Shkodër kanë filluar edhe më vonë. Kështu, specialistë të policimit në komunitet të qarkut Durrës kanë konfirmuar se, përgjatë vitit “...2019 nuk është kryer vlerësimi i riskut edhe sepse nuk kishim marrë trajnimet e duhura. Në vitin 2019 plotësoheshin vetëm formularët e UMM/UM. Vlerësimet e riskut kanë filluar të plotësohen prej muajit Shkurt të vitit 2020. Që nga muaji Shkurt 2020, vlerësimet e riskut bëhen për të gjitha rastet e dhunës, pa përjashtim”.

Gjatë vitit 2021 rezultoi edhe një përmirësim i dukshëm i bashkëpunimit të policisë me KVDHF për kryerjen e vlerësimit të riskut. Kështu, punonjësit e policisë së Qarkut Tiranë shprehen se: “Me kënaqësi konstatojmë se për vitin 2021 kemi përmirësim të bashkëpunimit të policisë me KVDHF në kryerjen e vlerësimit të riskut dhe rritje të rasteve për të cilat është lëshuar UMPMM”. Kjo dëshmon përmirësimin e procedurave për vlerësimin e riskut dhe një zbatim më të mirë të udhëzimeve të ministrave për këtë qëllim. Njëkohësisht, ky fakt është konfirmuar edhe nga disa prej të intervistuarve. P.sh., Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje në Bashkinë Durrës, është shprehur se: “Për vitin 2021 ka filluar funksionimi i procesit të vlerësimit të riskut. Menjëherë, sapo njoftohemi nga SPZ paraqitemi në Drejtorinë Rajonale të Policisë dhe bashkëpunojmë për kryerjen e vlerësimit të riskut për jetën e viktimës së dhunës në familje”.

Konkluzion: Lidhur me këtë çështje mund të shprehim një konkluzion paraprak nga monitorimi. Mendojmë se ndryshimet ligjore të vitit 2018 në LDHNF kanë qenë të nevojshme për rritjen e efektivitetit të mbrojtjes nga ana e policisë dhe mekanizmit vendor kundër dhunës në familje. Ato krijuan një bazë më të shpejtë ligjore për veprimet e saj të menjëhershme në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Mendojmë se vendosja në efikasitet e ndryshimeve ligjore të vitit 2018 ka qenë e vonuar. Kjo ka ndodhur për shkak të ngadalësisë së institucioneve përgjegjëse për të marrë masat, me qëllim përgatitjen e trajnimit e stafit të strukturave përgjegjëse. Gjithashtu, rezultoi se nuk janë marrë masa paraprake përpara procesit të miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit. Nuk ishin përgatitur paraprakisht, protokollat, trajnimet dhe projektaktet e nevojshme. Parapërgatitja për zbatimin e aktit do të kishte ndihmuar që vënia në efikasitet e ligjit të kryhej në një kohë më të shkurtër.

2. Përvoja pozitive për vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e rastit

Nga monitorimi i veprimtarisë së punonjësve të policisë ka rezultuar se aktualisht, gjatë kohës që u krye ky monitorim, mjaft specialistë dhe ndihmës specialistë të Policimit në komunitet ***kanë njohuri të mira mbi amendimet ligjore*** të tij, përfshirë edhe ato të vitit 2018. Gjithashtu, nga monitorimi dhe intervistimi ka rezultuar se ***punonjësit e policisë kanë një kuptim të qartë për rëndësinë e vlerësimit të riskut***. Punonjësit e policisë të intervistuar e kuptojnë kryerjen e vlerësimit të riskut si një detyrim ligjor. Për këtë, kanë ndihmuar mjaft trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me partnerët për zhvillim, si dhe pjesëmarrja e punonjësve në trajnimet që realizohen nga organizata të shoqërisë civile.

Në shumicën e rasteve monitoruesit gjetën se, ***Policia e përgatit me korrektesë dokumentacionin*** e plotë të praktikës që është ndjekur për trajtimin e rastit. Në qarkun Tiranë e Durrës rezultoi se respektohen sistematikisht formatet e miratuara me udhëzime të ministrave përkatës për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM-së⁴.

Gjithashtu, ***një komunikim i mirë zhvillohet midis strukturave të policisë***. P.sh., në rastet kur, vendi ku është raportuar dhunë në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit, për vlerësimin e riskut, punonjësit e policisë kanë kërkuar informacion nga struktura përgjegjëse e policisë së vendbanimit të viktimës.

Përvoja pozitive afirmohet edhe në respektimin e afateve ligjore. Objekt monitorimi u bënë afatet ligjore të lëshimit të UMPMM-së. Rezultoi se në përgjithësi, afatet janë respektuar nga policia e shtetit.

⁴ Shih: “Udhëzim i përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje” dhe Udhëzim i përbashkët nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”.

U konstatua se, në qarqet Tiranë e Durrës, ka ***punonjës të policisë që e kryejnë vlerësimin e riskut në të gjitha rastet***, pavarësisht llojit të dhunës dhe nivelit të rrezikut për jetën. Kështu, pyetjes sonë nëse kryhet në çdo rast vlerësimi i riskut, një nga specialistët e policimit në komunitet në qarkun Tiranë, iu përgjigj: “*Vlerësimin e riskut e kryejmë në të gjitha rastet. Nuk ka asnjë rrethanë apo shkak që mund të na bëjë të mos realizojmë vlerësimin e riskut. Jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që mbajmë nëse nuk parandalojmë dhunën dhe viktima përballet me një dhunë edhe më të rëndë*”. E njëjta përvojë u ndesh në Komisaratin e policisë nr. 3 dhe nr. 5, Tiranë: “*Për të gjitha rastet e dhunës në familje të raportuara është bërë vlerësim i riskut;*”(NSPZ, Kom.Pol nr.3). “*Bëjmë vlerësim risku për çdo rast, edhe për dhunë psikologjike*” (SPZ, Kom.Pol. nr.5).

Ne konsiderojmë se kjo praktikë është plotësisht në përputhje me ligjin.

Punonjësit e policisë kanë konfirmuar se vlerësimi i riskut kryhet edhe në mungesë të KVDHF/Punonjësi social të bashkisë. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak se policia nuk i ka njoftuar këta punonjës ose ata nuk janë paraqitur. Në bazë të Udhëzimit të ministrave, Policia duhet të njoftojë KVDHF. Një nga punonjësit e Policisë në Tiranë thekson se, “*Njoftohet KVDHF për çdo rast. Reflektohet në raportin e shërbimit koha e njoftimit të KVDHF.*” Por, ***sidoqoftë, policia nuk mund të mos kryejë vlerësimin e riskut për shkak të mungesës së KVDHF ose punonjësit social.*** Pra, tw gjithw oficerwt e policisw duhet tw kwrkojnw kryerjen e njw vlerwsimi tw riskut nw tw gjitha rastet e dhunws nw familje dhe gjithmonw, pwrpara se tw mbyllet njw rast i tillw.

Përvoja pozitive u vërejtën edhe në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Në këtë aspekt u konstatuan përvoja të efektshme nga Policia dhe Mekanizmi Vendor i Referimit të rasteve. Sidoqoftë, u vërejtën edhe diferenca në trajtim, të cilat do të sqarohen gjatë këtij punimi. Në këtë pjesë po përmbledhim shkurtimisht përshkrimin e menaxhimit të rastit nga njeri prej të intervistuarve, SPZ, Komisarati i Policisë nr. 5 Tiranë: “*...Vlerësojmë çdo rast njoftimi të dhunës në familje që bëhet në sallën operative nëpërmjet 112, edhe kur njoftimi është i rremë. Rastet e dhunës në familje i konsiderojmë prioritare, qetësojmë viktimën, i tregojmë që policia është mbrojtëse e saj, i krijohen kushtet e ngrohta për intervistim, e pyesim për problematikën që ka, e pyesim për ngjarje të dhunës që ka pasur në të kaluarën, ndërkohë shoqërohet dhe dhunuesi në komisarariat nëse nuk është larguar nga banesa, plotësojmë formularin e UM, bëjmë vlerësimin e riskut.*” Një punonjës tjetër thekson faktin se, “*Në momentin e njoftimit të viktimës në sallën operative, patrulla kalon menjëherë në zonën ku ajo banon për kontrolluar dhe shoqëruar viktimën në komisarariat*”.

Përvoja pozitive të menaxhimit të rasteve ndeshëm edhe pranë mekanizmave vendore. Në vijim, kemi përmbledhjen e menaxhimit të një rasti të dhunës në familje nga mekanizmi vendor Shkodër, bazuar në intervistat e zhvilluara me punonjësit e Bashkisë: “*ETN-ja mbliidhet ad-hoc,*

në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblidhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin. (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktimja. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mblidhet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë. Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës”.

Konkluzione paraprake: Rezultoi se nuk mungojnë përvojat pozitive në vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Suksesi në menaxhimin e rastit arrihet në sajë të bashkëpunimit të policisë së Shtetit me organet vendore në kuadër të funksionimit të Mekanizmit të referimit të rasteve, gjë e cila jo gjithmonë funksionon në rregull. U konstatuan praktika të ndryshme e në ndonjë rast edhe mosveprime, të cilat duhet të unifikohen dhe rregullohen.

3. Unifikimi i praktikës mbi bazën përvojave pozitive

Përgatitja e dokumentacionit për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM-së

Gjatë monitorimit, u gjetën edhe raste të mosnjohjes së mjaftueshme të ligjit dhe të akteve të tij nënligjore për vlerësimin e riskut. Veçanërisht në policinë e qarkut Shkodër, u konstatuan lëvizje të shpeshta të punonjësve në sektorin e dhunës në familje. Ky fakt, si dhe mungesa e trajnimeve, bënte që disa anëtarë të stafit të kësaj strukture të mos njiheshin ende me formatet dhe procedurat për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM-së. Raste të ngjashme u evidentuan edhe në Durrës e Tiranë. Është e nevojshme që përvojat pozitive në këtë aspekt të zbatohen dhe të shërbejnë si bazë për unifikim. Për këtë është e nevojshme jo vetëm njohja me Ligjin nr. 47/2018, por edhe me dy aktet nënligjore për zbatimin e tij, pra me dy udhëzimet e përbashkëta. Për këto raste duhet të përdoren modelet që vijojnë: “Model i raportit për vlerësimin e riskut” për rastin e dhunës në familje dhe “Model i Urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”. Të dyja janë referuar në dy udhëzime të përbashkëta të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përkatësisht, Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje” dhe Udhëzimin e Përbashkët nr.912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”.

Kryerja e vlerësimit të riskut dhe faktorët që kanë penguar kryerjen e tij në çdo rast

Ne mendojmë se në zbatim të ndryshimeve ligjore, Policia e Shtetit duhet të kryejë vlerësimin e riskut në çdo rast. Por, nga monitorimi dhe intervistimi rezultoi se përvojat për vlerësimin e riskut ishin të ndryshme. Përveç rasteve ku vlerësimi i riskut kryhej rregullisht për çdo çështje dhune të raportuar, u konstatuan edhe raste që trajtoheshin ose përmbylleshin pa kryer paraprakisht vlerësimin e riskut. Edhe në qarqet Tiranë e Durrës pati të intervistuar që u shprehën se, jo në të gjitha rastet kryhet vlerësimi i riskut.

Pasi konstatuam këtë situatë, monitorimi ynë u fokusua në gjetjen e faktorëve që na shpiten në anashkalimin ose moskryerjen e vlerësimit të riskut. Punonjësit e policisë iu përgjigjën pyetjeve që vijnë: *A ka ndonjë rrethanë ku ju vendosni të mos kryeni vlerësimin e riskut? Cilat janë shkaqet pse ju nuk e kryeni vlerësimin e riskut?*

Përgjigjet nuk ishin të njëjta dhe përmbanin shkaqe të ndryshme. Kështu p.sh., në një praktikë, vlerësimi i riskut kryhej vetëm kur kërkohej UMM, ndërsa kur kërkohej UM, nuk bëhej vlerësim. Kjo praktikë bazohej në logjikën që nuk kishte nevojë të menjëhershme për mbrojtje. Një qasje tjetër praktike ka qenë kryerja e vlerësimit të riskut “vetëm për rastet me rrezikshmëri të lartë” si dhe kur çështja referohej pranë OPGJ-së⁵. Faktorë të tjerë që u evidentuan nga të intervistuarit në të tria rrethet, ishin edhe “...përsëritja e dhunës nga dhunuesi, karakteri i dhunshëm i dhunuesit, varësia e dhunuesit ndaj alkoolit dhe substancave narkotike, shenjat e dhunës në trup të viktimës, etj.”. Ne vendosëm në një renditje të gjithë faktorët e përmendur nga intervistat e kryera në listat që vijojnë më poshtë.

Lista 1. Faktorët që ndikojnë për të ndërmarrë vlerësimin e riskut janë:

- prania e dhunës fizike;
- konflikt evident dhe shkallë e lartë rreziku;
- nëse ka pasur precedent penal;
- nëse ka pasur incidente të mëparshme të dhunës në familje;
- nëse ka pasur UMM ose UM të mëparshëm;
- varësia e dhunuesit ndaj alkoolit dhe substancave narkotike;
- kur krijohet bindja se situata e dhunës është e rëndë dhe mund të agravojë;
- shenjat e dhunës në trup të viktimës;
- prania e fëmijëve gjatë episodeve të dhunës dhe dhuna ndaj fëmijëve;

⁵ Një nga të intervistuarit u përgjigj: “Nuk kryejmë vlerësim të riskut në çdo rast. Për kërkesat për UMM bëjmë gjithmonë vlerësimin e riskut, ndërsa tek kërkesat për UM nuk bëjmë gjithmonë vlerësimin e riskut. Po ashtu në rastet e dhunës fizike, kur bëhet kallëzim penal pranë OPGJ, bëjmë vlerësimin e riskut. Kur dhunuesi është arrestuar nuk kemi bërë vlerësimin e riskut, se ai është në burg. Mendoj se vlerësimi i riskut nuk duhet të bëhet në çdo rast”.

- mungesa e ndjenjës së pendimit;
- gjendja e rënduar psikologjike e viktimës;
- reputacioni i dhunuesit në komunitet;
- nëse posedon armë apo jo;
- papunësia e dhunuesit;

Nga intervistat arritëm të evidentojmë edhe faktorët që ndikojnë bindjen e punonjësve të policisë për të mos ndërmarrë një proces për vlerësimin e riskut.

Lista 2: Faktorët që ndikojnë për të mos ndërmarrë një proces për vlerësimin e riskut.

- viktima po e keqpërdor këtë mjet për të bërë zgjidhjen e martesës;
- viktima po e keqpërdor këtë mjet për të bërë ndarjen e pasurisë;
- raste të abuzimit me të drejtën për tu mbrojtur;
- nuk banojnë në të njëjtën banesë;
- nuk paraqesin rrezikshmëri në dukje;
- kur viktima refuzon të bëhet vlerësimi i riskut, vetëm do të bëjë deklaram dhe nuk kërkon të merren masa të tjera⁶;
- krijojmë bindjen e brendshme se dhunuesi do të ndërpresë aktet e dhunshme dhe nuk do të vazhdojë më;
- bëhet zgjidhja me marrëveshje e konfliktit;
- rastet kur niveli i rrezikut është i ulët;
- rastet e dhunës psikologjike;
- nuk bindem për ekzistencën e dhunës në familje;
- është rast i veçuar dhune të lehtë;
- palët shfaqin pendesë;

Mund të evidentohen edhe disa rrethana të tjera që përmenden nga pak intervista.

Lista 3. Rrethana të veçuara për moskryerjen e vlerësimin të riskut.

- Viktima nuk pranon të bëjë deklaram për urdhër mbrojtje, as kallëzim e as denoncim, vetëm dëshiron që të bëjë një presion ndaj dhunuesit (këto raste mbyllen me një deklaratë pajtimi);

⁶ “Kemi raste që “viktimat” vijnë dhe pyesin, po të marr një UM, a përfitoj shtëpi, ndihmë ekonomike, e burgosni ju burrin se nuk dua që ai të vuaj dënimin me burg. Më pas ikin dhe nuk bëjnë deklaram”, deklaron një SPZ i intervistuar në Tiranë.

- Gruaja në polici dhe thotë që do të dalë burri nga burgu pas një jave dhe dua UM, kur ndaj saj nuk është ushtruar fare dhunë në familje;
- Kur kërkohet mbrojtje nga persona të panjohur që i kanë ngacmuar nëpërmjet telefonit.

Konkluzion: Të gjitha rrethanat e mësipërme meritojnë të analizohen në mënyrë të veçantë, një e nga një. Por, paraprakisht arrijmë në konkluzionin se, disa nga shkaqet e renditura nga punonjësit për të mos kryer këtë vlerësim nuk janë aspak bindëse. Kështu, p.sh., duhet të bëhet kujdes me evidentimin e rasteve të abuzimeve me kërkesën, ose me pendesën. Gjithashtu, mendojmë se fakti që është ushtruar vetëm dhunë psikologjike nuk mund të jetë një arsye për të mos kryer vlerësimin e riskut. Kujdes duhet të bëhet edhe në rastet kur palët arrijnë një mirëkuptim përpara policisë. Ka raste që menaxhimet me pajtim nuk janë të suksesshme.

Disa shkaqe të përmendura si më sipër tregojnë se një vlerësim paraprak i riskut është kryer, madje është arritur në konkluzionin se kemi të bëjmë me rrezik të ulët. Kjo duhet të pasqyrohet si një vlerësim risku i shkurtër paraprak.

Në përfundim, *sugjerojmë që përvoja ku vlerësimi i riskut të kryhet në çdo rast, duhet të unifikohet në të gjitha strukturat e policisë së shtetit.*

4. Burimet e informacionit të përdorura nga Policia në vlerësimin e riskut

Monitoruesit pyetën punonjësit e policisë se në cilat informacione bazohen ata për të kryer vlerësimin e riskut. Të intervistuarit dhanë përgjigje të ndryshme, të cilat mund t'i grupojmë në listën e mëposhtme.

Lista 1. Burimet kryesore të informacionit të përdorura nga Policia në vlerësimin e riskut janë:

- informacioni që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës;
- informacioni që mund të mblidhet menjëherë nga pyetja e të dhunuarës/it;
- informacioni që mund të mblidhet nga pyetja e dhunuesit;
- intervista me familjarët e tyre;
- intervista me personat që kanë qenë të pranishëm gjatë konfliktit;
- burime konfidenciale të sigurimit të informacionit;
- informacioni nga sistemi Tims dhe Adams;
- informacioni nga informatorët konfidencialë në komunitet;
- informacion nga Njësia Administrative dhe KVDHF;
- të dhënat për dhunuesin në TIMS;
- burimet konfidenciale të informimit;
- informacioni që vjen nga pyetja e banorëve të zonës dhe reputacioni që ka në komunitet.

Konkluzion: Konsiderojmë se në tërësi, burimet e informacionit janë të ndryshme, diverse dhe relevante për vlerësimin e riskut. Ajo që sugjerojmë është krijimi i praktikave të konsoliduara ku disa prej burimeve të informacionit të përdoren rregullisht nga Policia. Kështu, përveç pyetjes së dhunuesit dhe të dhunuarës, familjarët që pyeten duhet të jenë të afërm nga të dyja palët, edhe të dhunuesit edhe të të dhunuarës. Gjithashtu, është mirë që policia të ketë një protokoll për të garantuar standardet minimale për pyetjen e subjekteve që japin informacionin më të domosdoshëm për vlerësimin e riskut.

5. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me KVDHF/Punonjësit socialë përgjatë vlerësimit të riskut

Një vëmendje e veçantë në monitorim iu kushtua bashkëpunimit institucional, si një nga aspektet më të rëndësishme të amendamenteve ligjore të vitit 2018. Specifikisht, pyetjet u përqendruan në bashkëpunimin midis policisë së shtetit dhe koordinatorëve vendore. Realizuaam monitorimin e disa pikave të amenduara në ligj, si dhe në udhëzimet e përbashkëta të ministrave që kanë dalë në bazë e për zbatim të tij. Në këtë kuadër, punonjësve të policisë u është kërkuar të përshkruajnë procesin e njoftimit të KVDHF-së pranë njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore. Nga ana tjetër, edhe koordinatorëve vendorë të qarqeve të monitorura, u është kërkuar të përgjigjen në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në vlerësimin e riskut, si dhe në lidhje me këndvështrimin e tyre për bashkëpunimin me policinë e shtetit. Nga përgjigjet që morëm dhe ballafaqimi midis tyre, arritëm në disa gjetje të rëndësishme që i shërbejnë mjaft bashkëpunimit midis tyre, të cilat do t'i rendisim në vijim.

U vlerësua se në bashkëpunimin KVDHF-policë funksionon mirë pjesëmarrja në mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, shkëmbimi i informacionit në raste të veçanta, mbështetja për rastet që janë dërguar në qendra të ndryshme, komunikimi midis tyre, bashkëpunimi në menaxhim, etj⁷. Në të tria qarqet, Tiranë, Durrës dhe Shkodër u konstatua se kishte KVDHF ose PMF që kishin një bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat e policisë së shtetit, njiheshin shumë mirë midis tyre dhe bashkëpunonin për vlerësimin e riskut si dhe në kuadër të funksionimit të ekipit teknik disiplinor të mekanizmit vendor të referimit. Megjithatë, duhet theksuar fakti që u evidentuan mungesa në burime njerëzore e vecanërisht KVDHF, e cila nuk ishte emëruar ende në Bashkinë Shkodër, në bashki të tjera kryente disa funksione njëkohësisht, kurse në njësitë administrative Tiranë, në vend të saj bashkëpunonte me policinë Tiranë, PMF.

⁷ Nga intervistat e kryera me KVDHF dhe specialisten kundër dhunës në familje në NJA Sukth dhe raportet e monitorimit të GADC <https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Raport%202019%20Durrës.pdf>

Përgjatë intervistimit punonjësit e policisë u pyetën nëse e njoftonin ata në çdo rast koordinatoren vendore për të marrë pjesë në vlerësimin e riskut, sikurse theksohet në Udhëzimin e sipërpërmendur të ministrave. Gjithashtu, u kërkua që të përshkruanin procesin se si e njoftonin koordinatoren vendore për të marrë pjesë në procesin për vlerësimin e riskut. Ky proces është shumë i rëndësishëm pasi krijon mundësi për të mbështetur më mirë viktimat me ndihmë psiko-sociale, si dhe për të koordinuar të gjitha shërbimet e mbështetjes me mekanizimin vendor të referimit.

Pyetje të ngjashme iu drejtuan edhe punonjësve socialë pranë bashkive, si dhe kordinatorëve vendorë.

Nga përgjigjet e të intervistuarve konstatuam se përvojat e krijuara kishin dallime. Megjithatë, mund të përgjithësojmë disa nga gjetjet më të rëndësishme, pasi konstatuam se ka nevojë edhe për unifikimin e procedurave që ndiqen. Konkretisht, rendisim si vijon:

Së pari, në lidhje me njohjen e procedurave të bashkëpunimit nga punonjësit e policisë së shtetit për vlerësimin e riskut, konstatuam se në përgjithësi punonjësit i njihnin procedurat dhe ishin në dijeni të kërkesave të sanksionuara në udhëzimin e përbashkët të ministrave për vlerësimin e riskut. Në një rast në qarkun Shkodër, punonjësi nuk ka qenë i qartë se duhet të njoftonte KVDHF për të pranishmë gjatë vlerësimit të riskut. Përgjatë intervistave u diskutua në mënyrë më të thelluar dhe më të detajuar për ndjekjen e këtyre procedurave. Punonjësit e policisë dhe ata bashkiakë u shprehën se përfituan shumë nga intervista dhe diskutimet e organizuara.

Së dyti, në lidhje me njoftimin e koordinatoreve vendore praktikave të vërejtura ishin të ndryshme. Kështu, u vërtetuan pak raste ku KVDHF njoftohej në çdo rast dhe në çdo kohë. Kjo u evidentua vetëm në disa raste nga intervistat e punonjësve të komisarivateve të policisë, Tiranë, nr. 2, nr. 3, nr. 5, nr. 6. Këtu punonjësit deklarojnë se: “...kryejnë njoftimin në çdo kohë, edhe në orën 10 të natës dhe koordinatori përgjigjet në çdo kohë”. Në mjaft raste të tjera, në Tiranë, Durrës dhe Shkodër, KVDHF nuk njoftohej në çdo rast dhe në çdo kohë. Si arsye për këtë mosnjoftim janë treguar fakti që mjaft raportime kryhen në orët e vona të natës, duke pamundësuar njoftimin e koordinatoreve të cilat punojnë me orar zyrtar. Ka edhe një rast në Shkodër ku si arsye është fakti që nuk ka një koordinatore vendore dhe për një kohë të gjatë policia e Shtetit nuk ka pasur dijeni për zëvendësimin e saj nga punonjësi social. Edhe në Bashkinë Durrës, njoftimi dhe pjesëmarrja në orët e vona të natës nuk kryhej. “Në rastet kur dhuna denoncohet në orët e vona të natës, nuk e shqetësojmë fare punonjësen sociale, nuk e thërrasim. Kur është ndonjë rast i thjeshtë dhune dhe gjykojmë që nuk është e nevojshme prania e punonjësës sociale, nuk e thërrasim”..., u shpreh njëri prej të intervistuarve.

Së treti, konstatojmë se në mjaft raste nuk bashkëpunohet me KVDHF, por NJMF. Me këto të fundit ka një bashkëpunim të ngushtë, vecanërisht në njësitë administrative në Tiranë. Ligji parashikon pjesëmarrjen e detyrueshme të NJMF në rastet kur janë dhunuar edhe fëmijët. Natyrisht, pjesëmarrja e PMF-së është e mirëpritur. Për më tepër, udhëzimi i përbashkët i ministrave parashikon rastin e zëvendësimit të KVDHF, kur kjo e fundit është në pamundësi. Por, nëse ka mbivendosje, ose mosorganizim, kjo duhet të zgjidhet nga vetë organet e bashkisë. Pozitiv mbetet fakti që specialisti vendor asiston vlerësimin e riskut dhe bashkëpunon me policinë për menaxhimin e riskut dhe të rastit. Por, ne nuk mendojmë që, duhet të lejohet një zhvendosje e komunikimit nga KVDHF tek PMF, pasi njoftimi i saj, i parashikuar nga Udhëzimi i përbashkët, ka për qëllim të vërë në lëvizje edhe mekanizmin e referimit kundër dhunës në familje, gjë e cila nuk mund të kryhet nga NJMF-ja.

Së katërti, njoftimi me telefon është një praktikë që ndiqet nga të gjithë, e cila është praktika më e shpejtë dhe më efektive. Të gjithë të intervistuarit kanë konfirmuar se nuk bëjnë ndonjë shpresë për njoftimet. Një praktikë e paunifikuar mbetet pranë policisë Tiranë. Nga disa intervista u vu re që punonjësit e policisë nuk lidheshin drejtpërdrejt me njësinë bashkiake dhe koordinatoren atje, por me sallën operative të policisë. Ata shprehen se kjo duhet të jetë praktika e unifikuar. Pra, duhet të jetë detyrë e sallës operative që të njoftojnë KVDHF ose punonjësen sociale. Gjithashtu, në Tiranë, i cili është qark i madh dhe me shumë njësi vendore, një paqartësi është krijuar edhe me personat e kontaktit. Kështu, p.sh., ka pasur raste kur punonjësi i policisë njofton Bashkinë Qendrore, dhe pret nga këto të fundit që të njoftojnë minibashkitë. Mendojmë se këto përvoja sjellin vonesa të panevojshme, prandaj, duhet të unifikohen praktikat dhe kontaktet e drejtpërdrejta.

Së pesti, në lidhje me dokumentimin e kontakteve të bashkëpunëtorëve, monitoruesit u kujdesën që të shihnin nëse ishin të pajisur në mënyrë të ndërsjellë punonjësit me personat e kontaktit për këtë çështje. Pra, u kërkua nëse janë të afishuara kontaktet e strukturës policore në Bashki dhe anasjelltas. Kjo është shumë e rëndësishme që të mos kemi vonesa dhe mosorganizim. Në tërësi, të intervistuarit deklaruan se ishin pajisur me emrat dhe numrat e telefonit përkatës.

Së gjashti, në lidhje me asistencën e KVDHF-së, u konstatua se ka raste kur komunikimi vijon i rregullt edhe kur KVDHF zëvendësohet nga punonjësja sociale pranë bashkisë, ose nga PMF. Kjo procedurë parashikohet nga udhëzimi i përbashkët i ministrave. Ja si shprehen punonjësit SPZ të policisë Tiranë: “Unë kontaktoj KVDHF, nëse ajo nuk mundet, telefonon kolegen punonjëse sociale dhe e zëvendëson ajo direkt”, (SPZ, Kom. Pol. Nr.5); “KVDHF zëvendësohet nga punonjësja sociale, kur ajo vetë nuk mundet”. (Kom.Pol. Vorë). U konstatua se ka raste kur nuk njoftohet KVDHF, por salla operative, e cila njofton psikologët e punësuar nga policia. Ja si shprehet një punonjës i komisarariatit nr. 3 Tiranë, “Në çdo rast e njoftojmë NJMF/PMF, ose marrim në telefon sallën operative të policisë, të cilët na sjellin psikologë të policisë. Gjithmonë janë prezent”. Natyrisht, kjo përvojë është pozitive, pasi ndikon në përmbushjen e standardeve të

vlerësimit të riskut. Por, pavarësisht se është pozitiv fakti që një psikologe asiston në vlerësimin e riskut, përvoja e bashkëpunimit me KVDHF mbetet e palotë. Kjo, pasi një zvendosim i tillë ndërpret zinxhirin e komunikimit me KVDHF dhe mekanizmin e referimit.

Nga ana tjetër, vështirësi më të mëdha në komunikim ka pasur në Tiranë. Të intervistuarit nga Bashkia Tiranë theksojnë se, *“Si KVDHF ndërveprimi ndodh me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, KVDHF nuk ka kontakte me komisaritet, ajo kontakton me personin përgjegjës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe pika e kontaktit në DVP Tiranë më pas vijon kontaktimin me komisaritet e policisë, SPZ për menaxhimin e një rasti specifik”*. Kjo ka ndodhur për shkak të numrit të lartë të rasteve të dhunës në familje në Tiranë”.

Edhe nga intervistat e punonjësve sociale konstatojmë se komunikimi më i shpeshtë me policinë e Shtetit ndodh më tepër për menaxhimin e rastit dhe më pak për vlerësimin e riskut. Kjo u konstatua edhe në Durrës e Shkodër. P.sh., në bashkinë Durrës rezulton se policia nuk ka njoftuar KVDHF dhe nuk është asistuar për çdo rast nga KVDHF në vlerësimin e riskut. Specialistja për barazinë gjinore në Njësinë Administrative në Sukth, e cila kryen edhe detyrat e KVDHF pranë kësaj gjinie, konfirmon përgjigjen ndaj çdo thirrje të policisë ditën, por nuk ka ndodhur të jetë thirrur natën. Ajo mendon se është ndër një ndihmuese në menaxhimin e rasteve dhe ofrimin e shërbimeve krahasuar me procesin e vlerësimit të riskut.

Madje, ajo thekson se, roli i saj nuk ka qenë gjithmonë aktiv në kryerjen e vlerësimit të riskut. *“Kur kam shkuar në polici vlerësimi ka qenë pothuajse i kryer. E kam lexuar dhe kam shprehur dakordësinë me vlerësimin e riskut dhe nivelin e riskut të konstatuar. Po, kam kontribuar në lidhjen e vlerësimit të riskut me masat e UMPMM”*. Kjo përvojë nuk është rezultative. Qëllimi i ligjit udhëzimit të përbashkët të ministrave është ndihmesa që duhet të ofrohet nga KVDHF ose punonjësi social, në mënyrë që raporti i vlerësimit të riskut të jetë sa më efektiv. Pra qëllimi nuk është vetëm firmosja e raportit, gjë që nuk është as detyrim ligjor.

Rastet kur policia nuk e njoftonte KVDHF ishin: në ditë pushimi -në ditë festash, në orët e vona pas orarit zyrtar, në rastet e dhunës psikologjike dhe rastet me rrezik të ulët si dhe në rastet kur KVDHF banon larg dhe e ka të vështirë t’u përgjigjet në kohë. Ky nivel bashkëpunimi është konfirmuar si nga intervistat me punonjësit e policisë ashtu edhe nga intervista me koordinatoren vendore kundër dhunës në familje dhe specialisten kundër DHF, në NjA Sukth.

Këto probleme konfirmohen edhe nga të gjithë të intervistuarit në Bashkinë Shkodër. Madje, sikurse theksuam, në këtë bashki nuk është emëruar ende një koordinator vendor KVDHF. Punonjësit e policisë nuk kishin kontakte as të punonjësit social që mund të kryente funksionet e tij. Mungesa e kontakteve të punonjësve socialë të Bashkisë është një nga shqetësimet e ngritura të policisë së shtetit, në këtë Bashki.

Konkluzion. Monitoruesit vlerësojnë se vetëm përgjatë vitit 2021 është vendosur bashkëpunimi midis punonjësve të strukturave kundër dhunës në policinë e shtetit dhe KVDHF-ve. Procedurat dhe praktikat për këtë bashkëpunim kanë nevojë të unifikohen dhe përmirësohen. Këto procedura nuk janë të unifikuara në të gjitha bashkitë e madje, edhe brenda të njëjtës bashki gjejmë praktika të ndryshme pune. Për këtë nuk është e mjaftueshme që vetëm policia e shtetit të miratojë protokolle, por ka nevojë për një aktivizëm më të madh nga ana e koordinatorëve vendorë dhe mekanizmave të referimit. Për më tepër, ka nevojë të rishikohet çështja e KVDHF për Tiranën e cila është një Bashki e madhe dhe ka mjaft njësi administrative.

Nevojitet një listë me kontaktet në bashki dhe në policinë e shtetit, në mënyrë që të njoftohen personat përgjegjës për vlerësimin e riskut sa herë që ka raste të dhunës në familje; Kjo listë duhet të jetë e vlefshme edhe për sallën operative të policisë, në mënyrë që t'i njoftojë, menjëherë, sikurse ndodh p.sh. me urgjencën; Punonjësit e Policisë theksojnë se, shërbimet sociale në bashki duhet të garantojnë pjesëmarrjen e KVDHF ose zëvendësimin e saj me punonjëse sociale në rastet kur policia kërkon pjesëmarrjen e tyre në vlerësimin e riskut, ditën, natën, brenda dhe jashtë orarit zyrtar, si dhe në ditë festash.

Për bashkinë Shkodër nevojitet emërimi sa më parë i një Koordinator Vendor Kundër Dhunës në familje.

Leximi i vëmendshëm i legjislacionit dhe zbatimi i VKM-së “*Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës*”, do të sjellë përmirësimin e punës dhe të bashkëpunimit Polici-KVDHF.

6. Bashkëpunimi Polici-NJMF/PMF për vlerësimin e riskut

Të gjithë të intervistuarit u pyetën në lidhje me procesin e njoftimit të njësinë vendore të punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki, kur një i/e mitur është përballur me dhunë në familje? Nga monitorimi rezultoi një diferencë e madhe midis praktikave të bashkëpunimit për vlerësimin e riskut dhe atyre për menaxhimin e rastit. Praktikrat për vlerësimin e riskut rezultojnë ende të pakonsoliduara. Kurse, bashkëpunimi gjatë menaxhimit të rastit është më i qartësuar.

Vecanërisht në Tiranë, SPZ-të e intervistuar kanë pohuar se për rastet e të miturve të dhunuar në marrëdhëniet familjare nuk kryejnë asnjë veprim pa praninë e PMF ose të psikologes së policisë. Sikurse theksuam, në këtë Bashki, PMF në njësitë administrative kryen edhe detyrën e koordinatorës vendore të dhunës në familje. Një nga SPZ-të e intervistuar në Tiranë është

shprehur se: *“Rastet e të miturve i kemi me shumë merak dhe bëjmë të pamundurën që PMF të jetë prezent në procesin e vlerësimit të riskut”*. Kurse, një SPZ tjetër na thotë se, *“KVDHF/PMF mbështet SPZ në marrjen në pyetje të viktimës dhe të të miturit, qetësimin e viktimës, marrim në konsideratë opinionin e saj në lidhje me nivelin e riskut. Kur viktimë dhe i mituri shikojnë një vajzë/grua në rolin e punonjësës sociale/KVDHF/PMF pranë vetes ose pranë nënës ndihen më rehat, më të sigurtë, flasin më lirshëm, shprehin pa droje problemin e dhunës”*.

Por, ka edhe raste, kur procedurat kryhen ndryshe. Kështu, punonjës të policisë në të tria qarqet kanë treguar se ka edhe raste kur nuk i njoftojnë PMF- të, vecanërisht gjatë natës. *“Gjatë natës nuk i njoftojmë asnjëherë për të mos i shqetësuar. I njoftojmë pasi mbarojmë procedurat e trajtimit të rastit. Pjesa më e madhe e rasteve denoncohen gjatë natës dhe nuk i njoftojmë fare. Në mëngjes e vëmë në dijeni njësinë bashkiake për rastin e dhunës”*. Ka edhe raste kur PMF njoftohet kur procedurat kanë përfunduar në prani të psikologes së Policisë. *“Pasi mbarojmë procedurat e njoftojmë PMF në njësinë bashkiake. Në rastet e fëmijëve është e pranishme psikologjia e policisë”*.

Për fat të keq, ka edhe raste kur nuk është vendosur fare ky bashkëpunim për vlerësimin e riskut. Kjo konfirmohet në disa raste nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve. Kështu, p.sh., pyetjes nëse punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve kontaktohen nga policia për kryerjen e vlerësimit të riskut, punonjësja për mbrojtjen e fëmijëve në Njësinë Administrative 6 i është përgjigjur se, *“...nuk kontaktohet nga policia në çdo rast për kryerjen e vlerësimit të riskut për të miturit e dhunuar në marrëdhëniet familjare. Të gjitha rastet e trajtuara prej PMF në këtë Njësi Administrative janë dërguar në Komisaratin e Policisë nga PMF”*. Kurse, PMF në Njësinë Administrative nr.11, Tiranë, nuk ka asistuar policinë në vlerësimin e riskut në asnjë rast dhune në familje gjatë vitit 2020, kurse gjatë vitit 2019 u evidentua vetëm një rast.

Një problem tjetër me të cilën u ndeshëm ishte edhe çështja e bashkëpunimit me PMF-në në rastet kur fëmijët nuk kanë pësuar dhunë të drejtpërdrejtë. *“Gjithmonë thirret PMF për viktimat e drejtpërdrejta të dhunës në familje, ndërsa kur fëmijët janë dëshmitarë të dhunës në familje nuk e thërrasim PMF”*. Në fakt, ligji kundër dhunës në familje, parashikon referimin e rastit të dhunës pranë NJMF-së, jo vetëm kur dhuna është ushtruar ndaj fëmijëve, por edhe kur ajo është ushtruar në prani të fëmijëve. (Shih: neni 13/1, pika 4).

Konkluzion: Unifikimi dhe përmirësimi i procedurave për bashkëpunimin midis policisë së shtetit dhe PMF-së, vecanërisht gjatë vlerësimit të riskut për dhunën ndaj fëmijëve në familje, mbetet detyrë e rëndësishme. Nga monitorimi rezultoi se këto procedura nuk janë të unifikuara në të gjitha bashkitë e madje, edhe brenda të njëjtës bashki gjejmë praktika të ndryshme pune. Për këtë bashkëpunim ka nevojë për një pjesëmarrje më aktive nga vetë punonjëset PMF. Në këtë rast, krahas zbatimit të legjisllacionit kundër dhunës në familje, ka nevojë për njohje më të mirë dhe zbatim më të kujdesshëm të legjisllacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

II. Lëshimi i UMPMM dhe zbatimi i tij.

1. Lëshimi i UMPMM.

Procesi i lëshimit të UMPMM është një process i natyrshëm që vjen menjëherë pas vlerësimit të riskut. Punonjësit e policisë në Tiranë e Durrës deklarojnë se ky urdhër lëshohet pasi kryhet vlerësimi I riskut dhe rezulton risk mesatar ose I lartë. Kurse, vetëm në rastet kur nga vlerësimi i riskut rezulton se një risk i ulët, punonjësi I policisë nuk lëshon UMPMM. Punonjësit e policisë shprehin bindjen se lëshimi i Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme UMPMM ka dhënë efekt në parandalimin e dhunës në familje dhe është një mjet që rrit sigurinë e viktimave të dhunës në familje. Një nga punonjësit e intervistuar ka pohuar se: *“Është gjë shumë e mirë për ne vlerësimi i riskut dhe UMPMM, tashmë kemi një parashikim ligjor që lejon policinë të ndërhyjë me masa të shpejta për mbrojtjen e viktimës”*. Policia Shkodër nuk ka lëshuar ndonjë UMPMM përgjatë vitit 2020 dhe kishte vijuar me praktikat e mëparshme të kërkesave për UM dhe UMM nga Gjykata.

Gjatë monitorimit u konstatua se Policia vendos në UMPMM masat mbrojtëse në mënyrë proporcionale me nevojat e viktimës dhe situatën në të cilën ndodhet. Asnjë nga masat mbrojtëse nuk shihet si opsion i fundit nga punonjësi i policisë, por ato përzgjidhen në proporcion me nivelin e riskut. Kjo u konfirmua edhe nga punonjësit e Bashkisë Durrës. P.sh., KVDHF në Bashkinë Durrës dhe specialistja kundër dhunës në familje në Njësinë Administrative Sukth, konfirmuan se masat mbrojtëse të përfshira në UMPMM kanë qenë në përputhje me nivelin e vlerësimit të riskut.

Të intervistuarit theksojnë se një në mënyrë të vecantë vlerësojnë masat që duhet të merren në përputhje me rrezikun e jetës së viktimës. Ata e konsiderojnë *“Largimin nga banesa të dhunuesit e mendoj si masën e parë që duhet të jepet”*. Kjo është sanksionuar ligjërisht edhe në ndryshimet që iu bënë ligjit në vitin 2020. Por, nga ana tjetër ngrejnë shqetësime për zbatimin e kësaj mase, pasi mund të sjellë probleme me qëndrimin e dhunuesit të larguar nga banesa. Një punonjës i policisë së Shtetit Shkodër u shpreh: *“Mendoj që duhet të ketë strehëza për akomodimin e dhunuesve njësoj siç ka strehëza për akomodimin e viktimave të dhunës në familje. Largimi i dhunuesit nga banesa dhe lënia në gjendje të lirë, në mes të katër rrugëve, në mes të natës, në të ftohtë, përkeqëson gjendjen psikologjike të tij dhe shton rrezikun që i kanoset viktimës”*.

Nga intervistat ka rezultuar se ka raste kur punonjësi i policisë merr edhe mendimin e viktimës së dhunës në familje para se të vendosë në lidhje me masat mbrojtëse, duke u siguruar se ato janë

në proporcion me situatën dhe nevojat e viktimës për siguri apo nevoja të tjera. Megjithatë, UMPMM lëshohet pavarësisht nga vullneti i viktimës. Kështu, psh., punonjësit e policisë Durrës, kanë treguar qartë se Policia procedon me lëshimin e UMPMM, duke vepruar kryesisht, edhe në rastet e refuzimit nga viktima të këtij urdhri.

Pyetjes nëse keni raste që nuk lëshoni UMPMM, cilat janë arsyet për këtë vendim, morëm disa përgjigje, të cilat po i përmbledhim si vijon:

- e konsiderojmë të panevojshme;
- nuk ka rrezik;
- nuk jetojnë në të njëjtën banesë viktima dhe dhunuesi.

Autorët vërejnë se duhet pasur kujdes nëse ata nuk lëshojnë një UMPMM për shkak se familjarët jetojnë në vendbanime të veçanta. Fakti që viktima dhe autori nuk jetojnë së bashku nuk e zvogëlon rrezikun e saj për dhunë ose kërcënime nga ai.

2. Procedurat për zbatimin e UMPMM-së deri në vendimin e Gjykatës.

Zbatimi i UMPMM është një proces kompleks dhe kërkon bashkëpunimin e të gjithëve,. Janë disa procedura që kryhen nga strukturat kundër dhunës në familje pranë policisë së Shtetit në Tiranë e Durrës me qëllim vënien në zbatim të UMPMM-së. Këtë e treguan qartë të intervistuarit. Disa nga praktikat ngjasonin, por kishte edhe dallime midis tyre.

Në vijim po rendisim veprimet që kryhen nga Policia e Shtetit në Tiranë, në raport me subjektet që zbatojnë UMPMM.

- **Në lidhje me institucionet:** *“Njoftojmë kryeplakun e zonës dhe burimet konfidenciale të informimit në komunitet;”* (NSPZ, Kom.Pol.nr.6). *“Njoftohet patrulla e policisë që të mbikqyrë zonën ku banon viktima; Komunikohet shpesh me telefon më viktimën për tu siguruar për jetën dhe shëndetin e saj; Monitorohet/kontrullohet në distancë zbatimi i urdhrit, duke pyetur familjarët dhe komunitetin aty afër”.*
- **Në lidhje me viktimën:** *“I japim numrin e telefonit (viktimës) dhe po ashtu e informojmë për nr. 112 që të njoftojë në çdo rast që kërcënohet nga dhunuesi apo në çdo rast që ai shkel masat mbrojtëse”* (SPZ, Kom.Pol. Nr.5.). *“...E dërgojmë menjëherë në spital viktimën që të marrë ndihmën e shpejtë mjekësore nëse ka nevojë; Nxjerrim urdhër për kryerje të aktit të ekspertimit tek mjeku ligjor; E orientojmë viktimën të shkojë tek qendra shëndetësore për të bërë kontroll mjekësor dhe dokumentin e lëshuar nga mjeku ta depozitojë në gjykatë. (NSPZ, Kom.Pol.nr.6.). Informohet menjëherë viktima dhe dhunuesi verbalisht dhe u jepet nje kopje e urdhrit; Njoftohet patrulla e shërbimit për të monitoruar zonën ku banon viktima\mbahen kontakte të vazhdueshme me viktimën, si dhe shkohet herë pas here në banesën e saj nga policia pas lëshimit të UMPMM; (Kom i Policisë Shkodër).*

- **Në lidhje me dhunuesin:** Dhunuesit në momentin e njoftimit të UMPMM i merret deklarata me shkrim nëpërmjet një procesverbali ku ai deklaron se merr djeni për urdhrin dhe merr përsipër të mos shkelë masat mbrojtëse të urdhëruara. Njoftohet dhunuesi për përgjegjësinë penale nëse e shkel urdhrin;

Njoftojmë viktimën për UMPMM, shoqërojmë dhunuesin dhe i njoftojmë UMPMM, plotësohet kërkesa për vlerësimin e masave të urdhëruara në UMPMM dhe formulari për lëshim të UMM drejtuar gjykatës.

Viktima dhe dhunuesi marrin kopje të UMPMM, paralajmërohet dhunuesi për shkeljen e urdhrin dhe pasojat penale që vijnë në rast shkelje të tij.

Një detyrë mbetet menaxhimi i qëndrimeve të dhunuesit, i cili shpesh nuk bashkëpunon. Një i intervistuar theksoi se ka raste kur dhunuesi shprehet se do të vazhdojë të ushtrojë dhunë ndaj viktimës (p.sh. në një rast dhunuesi deklaronte: “Nuk keni çfarë të më bëni, gruaja është prona ime, bëj çfarë të dua me të, nuk keni të drejtë të ndërhyni, do ta rrah sa të dua!”)

- **Në lidhje me KVDHF:** i njoftohet UMPMM-ja KVDHF/punonjëses sociale me telefon, jo me shkresë. Kontributi i KVDHF është i domosdoshëm në lidhje me masat e marra në zbatim të UMPMM kur ato lidhen me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.
- **Në lidhje me ndjekjen penale:** Nga monitorimi ka rezultuar se ka një koordinim të SPZ me OPGJ në lidhje me referimin e çështjes për ndjekjen penale. Policia Shkodër thekson se, ka referuar rastin duke vepruar kryesisht, në rastet ku konstatohen elementë të veprës penale nga OPGJ, pavarësisht refuzimit të viktimës për të bërë kallëzim penal. Edhe policia Tiranë e Durrës thekson se, “Elementët e veprës penale vlerësohen nga OPGJ. Nëse është rast që duhet ndjekur penalisht, oficerët veprojnë kryesisht duke e referuar për ndjekje penale në prokurori këtë rast”; “Në rastet e rënda të dhunës e dërgojmë direkt tek OPGJ për të marrë kallëzimin penal edhe në rastet kur viktima nguron ta bëjë një gjë të tillë”.
- **Shpejtësia e procedurave.** UMPMM lëshohet në kohë, sipas afateve të parashikuara në ligj. Në fakt, nëse nuk lëshohet në kohë, është më e këshillueshme të mos përdoret si mjet, pasi mund të përdoren urdhrat e tjerë të mbrojtjes që lëshohen nga gjykata, sidomos UM.

Konkluzion: Në radhë të parë, mendojmë se do të ishte efektive, por është edhe në logjikën e ligjit që vlerësimi i riskut të kryhet në cdo rast. Mbi atë bazë të vlerësohen masat që duhet të merren, nëse do të lëshohet UMPMM kur ka nevojë për mbrojtje urgjente, apo do të kërkohet

UM nga Gjykata. Ne mendojmë se kërkesa për UMM nuk do të ishte e arsyeshme, pasi ajo presupozon emergjencë, gjë që mund të kryhet paraprakisht UMPMM dhe më tej të vijojnë procedurat në gjykatë. Prandaj, konkludojmë që pas vlerësimit të riskut Policia e Shtetit duhet të vendosë dy rrugë: ose të lëshojë UMPMM dhe të ndjekë procedurat më tej përpra Gjykatës, ose të kërkojë UM nga gjykata. Nga ana tjetër vlerësimi i riskut krijon mundësinë për të dokumentuar më mirë situatën dhe ndihmon më tej për procesin gjyqësor.

III. Zbatimi i vendimeve gjyqësore për UM, UMM.

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës për UM dhe UMM ka specifika që e dallojnë nga ekzekutimi i vendimeve të tjera gjyqësore. Një nga dallimet është edhe organi kryesor ekzekutues. Në urdhrat e mbrojtjes, organet kryesore që ngarkohen me përgjegjësi për këtë ekzekutim janë Policia e Shtetit, organet vendore dhe përmbartimi gjyqësor. Në këto kushte është e rëndësishme të konsolidohet veprimtaria e policisë së shtetit dhe e KVDHF, si dhe bashkëpunimi midis tyre me shërbimin përmbartimor.

1. Veprimtaria e policisë së Shtetit.

Nga monitorimi rezultoi se në Tiranë, policia e shtetit ka qartësuar detyrat e saj dhe i kryen ato me një vëmendje të posaçme kah respektimit të urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga palët. Më pak të dhëna kemi nga policia në rrethet Durrës dhe Shkodër.

Të intervistuarit theksojnë se, pasi gjykata sjell një kopje të UMM/UM, edhe pse palët mund të jenë njoftuar gjatë seancës gjyqësore ose mund të kenë marrë një kopje të vendimit në sekretarinë gjyqësore, përsëri thërrasin viktimën dhe dhunuesin për t'u bërë me dije vendimin. Për këtë mbahet një procesverbal ku deklarohen me shkrim se janë njohur me vendimin e gjykatës për lëshimin e UMM/UM, me masat mbrojtëse të urdhëruara. Viktima pyetet nëse ka pasur shqetësime deri në atë moment nga dhunuesi dhe angazhohet të njoftojë menjëherë policinë nëse do të shkelen masat. Ndërsa dhunuesi angazhohet se do të respektojë urdhërimet e gjykatës. Punonjësit e policisë tregojnë se ka pasur raste kur viktimat e dhunës në familje ka qenë shtetase e huaj dhe në këto raste kanë njoftuar përkthyes gjatë marrjes në pyetje.

Kjo procedurë ndiqet edhe kur dhunuesi është i arrestuar e ndodhet në burg, për shkak se viktimat mund të shqetësohen dhe të kërcënohen prej tij nëpërmjet mesazheve telefonike ose nëpërmjet kërcënimeve indirekte të dërguara nëpërmjet njërëzve të afërt. Në këtë rast thirret viktimat dhe mbahet procesverbal në prani të saj.

Kur vendqëndrimi i zakonshëm i viktimës dhe dhunuesit është i ndryshëm nga vendqëndrimi i përkohshëm ku kanë denoncuar dhunën, njoftohet komisariati përkatës. Kjo kryhet nëpërmjet

sallës operative duke njoftuar SPZ-në e zonës pranë atij komisarati ose përmes lidhjes direkt me telefon.

Disa nga veprimet e tjera që kryhen nga SPZ-të e zonës me qëllim respektimin e urdhrave të mbrojtjes janë edhe shoqërimi i viktimës nëse ka nevojë, kontrolli i banesës nëse dyshohet për armë, vizita pranë banesës herë pas here përmes patrullës së zonës, pyetje e herëpashershme e viktimës nëse është shqetësuar nga dhunuesi.

2. Monitorimi i zbatimit të UM nga KVDHF.

Ndryshimet ligjore të vitit 2018, sanksionuan detyra të posaçme për punonjësit socialë në lidhje me monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes. Sikurse thekson Lorena Bardeli, përgjegjëse në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër: “*Monitorimi i respektimit të urdhrave të mbrojtjes është detyrim ligjor që duhet zbatuar*”. Për të nxjerrë konkluzionet e nevojshme kemi ndjekur modelin e ofruar nga Bashkia Shkodër. Edhe pse pranë kësaj Bashkie nuk është emëruar ende një KVDHF, Zyra e shërbimeve sociale monitoron respektimin e UMM/UM nga palët. Gjatë vitit 2020 KVDHF ka dërguar pranë policisë 91 raporte monitorimi.

Në këto raporte, punonjëset sociale kryejnë dokumentimin dhe reflektimin e hapave të ndërmarrë në lidhje me mbështetjen dhe shërbimet e ofruara, rezultatet e monitorimit, nevojat e rastit, si dhe adresimin e tyre në institucionet përgjegjëse, sfidat e hasura gjatë procesit sipas masave të marra nga gjykata në vendimin gjyqësor për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje. Ato respektojnë afatin 60 ditor të përgatitjes së raportit të monitorimit. Kur KVDHF marrin dijeni për shkeljen e UM, raporti i monitorimit të zbatimit të UM-së i paraqitet policisë menjëherë, pa pritur të plotësohet afati prej 60 ditësh. KVDHF duhet të thërrasë edhe mbledhjen e ETN-së, duke e ndarë këtë informacion me të gjithë anëtarët, për marrjen e masave të koordinuara.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ***bashkëpunimi i organeve vendore më qendrat komunitare dhe OJF-të që ofrojnë shërbime në këtë fushë***. Ky bashkëpunim ka dhënë rezultate në identifikimin e problemeve përgjatë zbatimit të urdhrave të mbrojtjes. “*Çdo rast i trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, është trajtuar në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës dhe në bashkëpunim me institucionet / OSHC-të pjesë të MKR-së, ndaj vlerësojmë se trajtimi i çdo rasti ka qenë i sukseshëm*”.

Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile është forcuar edhe në bashkitë Durrës e Tiranë. Një bashkëpunim i tillë me shoqërinë civile reflekton praktikën e mira që përfshijnë ofruesit e shërbimeve të OJQ -ve në përgjigjen e përgjithshme ndaj dhunës në familje, pasi shoqëria civile shpesh i njih dhe i kupton më së miri nevojat e viktimave. Në lidhje me këtë nga intervistat në Bashkinë Durrës, rezulton bashkëpunimi i PMF-së me Qendrën Komunitare “*Sot për të*

Ardhmen”, Shoqatën “*Gender Paqe Siguri*”, etj. Megjithatë, në këto Bashki nuk është konsoliduar ende praktika e monitorimit frekuent të UM nga KVDHF. Më mirë të themi se monitorimi që kryhet është i rastësishëm dhe i padokumentuar me një raport, sikurse ligji e kërkon. Si shkaqe për moskryerjen e monitorimit të zbatimit të UM janë përmendur në mënyrë të vecantë, ndryshimi i banesës, ndryshimi i numrave të telefonit, ngarkesa e punës, pandemia dhe tërmeti, të cilat kanë vështirësuar përgatitjen e raportit përgjatë periudhës së monitorimit .

Konkluzion: Sa më sipër dëshmon qartë se strukturat kundër dhunës në familje pranë policisë së Shtetit, ushtrojnë veprimtari operative dhe kanë kontakte të shpeshta për monitorimin e sigurisë fizike të personave që mbrohen nga urdhrat e mbrojtjes. Ndërkohë, lind nevoja për të lidhur këto veprimtari me ato që kryhen nga punonjësit socialë të organeve vendore për monitorimin e zbatimit të UM-së në një afat 60 ditor. Nuk arritëm të shihnim se çfarë bëhet me raportet e monitorimit që duhet të dërgohen pranë policisë së Shtetit dhe me veprimet e përbashkëta që ndërmerren me ETN-në në vijim. Nga ana tjetër ka shumë punë për të bërë pranë Bashkive për konsolidimin dhe përmirësimin e praktikave të monitorimit të zbatimit të UM, me qëllim që ato të jenë më sistematike dhe më efektive. Për një efektivitet të tyre nevojitet që jo vetëm të konstatohen problemet e zbatimit të UM-së, por të merren edhe masat e nevojshme për t'i adresuar ato. Në këtë aspekt një rëndësi të madhe merr zbatimi i VKM-së për mekanizmin e referimit të dhunës në familje.

IV. SFIDA DHE PROBLEME TË IDENTIFIKUARA NË NIVEL TEKNIK NË TË TRIA BASHKITË.

TIRANË

Policia e Shtetit

Nga monitorimi kanë rezultuar disa sfida me të cilat janë përballur **punonjësit e policisë** në zbatim të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar për çështjet objekt monitorimi. Disa prej tyre janë:

- Mungojnë ambiente të përshtatshme në polici për të pritur viktimën e dhunës në familje dhe fëmijët e saj, kompjutera, printera dhe fotokopje të cilat janë shumë të nevojshme për mbarëvajtjen e punës;
- Specialistët e policimit në komunitet përballen me një ngarkesë të madhe detyrash krahas asaj të trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Punonjësit e policisë të intervistuar shprehin se trajtojnë një numër të lartë rastesh të dhunës në familje në një ditë dhe ndodh të përballen me disa raste dhune në familje njëkohësisht.

- Puna me dhunuesin ka nevojë të forcohet. Nxjerrja e dhunuesit nga banesa është një masë që e përball punonjës in e policisë me dhunuesin, i cili nuk e kupton që kjo masë parashikohet nga ligji për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje.
- Mungesa e shërbimit psikologjik falas dhe në çdo orë për çdo rast të raportuar dhune në familje ka bërë që punonjës in e policisë të marrin edhe atributet e psikologes, përveç detyrës policore, duke kryer edhe rolin e psikologut për viktimat;
- Punonjës in e policisë të intervistuar shprehen se barra më e rëndë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje i ka rënë policisë, që nga momenti i plotësimit të kërkesë padisë për UMM/UM, e deri tek monitorimi i zbatimit të masave mbrojtëse, pa pjesëmarrjen aktive të autoriteteve të tjera të parashikuara nga ligji.
- Është vlerësuar sfiduese për punonjës in e policisë në Tiranë trajtimi i rasteve kur dhunuesit janë persona me imunitet, deputetë ose gjyqtarë që gëzojnë mbrojtje.
- Janë konstatuar raste ku viktima bën deklaratë noteriale ku heq dorë nga mbrojtja nëpërmjet UMPMM, UMM/UM dhe e depoziton në polici duke pretenduar se është zgjidhur konflikti.

Bashkia

- Numri i lartë i rasteve të identifikuar të dhunës në familje është një sfidë për MKR pranë Bashkisë Tiranë për menaxhimin e rasteve si dhe për KVDHF në lidhje me monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes.
- Janë konstatuar vonesa në dërgimin e kopjes së vendimit të urdhrin të mbrojtjes nga gjykata të cilat sjellin efekte edhe në monitorimin e rastit dhe sigurinë e viktimës së dhunës në familje.

DURRËS

Policia e shtetit

- Mungojmë ambiente të përshtatshme për pritjen e viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre. Një nga specialistët e policimit në komunitet është shprehur: *“Aktualisht i presim viktimat e dhunës në familje në një zyrë në katin e parë të komisarariatit të policisë, ku intervista ndërpritet disa herë nga hyrje daljet; Kjo ndikon në psikologjinë e viktimës, e bën atë të ndërpresë rrëfimin dhe rrjedhën e ngjarjeve. Sa më i qetë ambienti aq më mirë shkon intervistimi”*.
- Ka mungesa edhe në kompjutera, printera, fotokopje, etj. Ngarkesa me të cilën përballen SPZ dhe NSPZ ishte një tjetër sfidë për punonjës in e policisë. Një nga specialistët e policimit në komunitet të intervistuar është shprehur gjatë intervistës se: *“Ne, ndonjëherë detyrohemi të lëmë rastin përgjysmë, pa mbaruar të gjitha dokumentet, për një ngjarje kriminale që mund të ndodhë”*.

- Ka mungesë informacioni në lidhje me emrat e saktë të qendrave të strehimit të grave të dhunuara, kontaktet e tyre, si dhe të organizatave të tjera që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje;
- Një tjetër sfidë me të cilën po përballet policia është identifikimi i rasteve të abuzimit me të drejtën për mbrojtje nga dhuna në familje. *“Kemi raste që “viktimat” vijnë dhe pyesin, po të marr një UM, a përfitoj shtëpi, ndihmë ekonomike, e burgosni ju burrin se nuk dua që ai të vuaj dënimin me burg. Më pas ikin dhe nuk bëjnë deklaram”*.

Bashkia

Nga monitorimi kanë rezultuar disa sfida me të cilat janë përballur **KVDHF dhe/ose specialistja e dhunës në familje** në zbatim të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar për çështjet objekt monitorimi. Disa prej tyre janë:

- Numri i lartë i rasteve të dhunës në familje kjo përbën një nga sfidat e MKR pranë kësaj bashkie.
- Burimet njerëzore për adresimin e dhunës në familje janë të kufizuara. Ka mungesa në lidhje me punonjësit socialë, të cilët mund të zëvendësojnë Koordinatorën Vendore Kundër Dhunës në Familje, kur ajo është në pamundësi për t’iu përgjigjur thirrjes së policisë për ta asistuar në vlerësimin e riskut. Edhe në Njësitë Administrative ka mungesa në staf të specializuar, përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Specialistja e dhunës në familje në NJA Sukth ka ndarë se është ndjerë më ndihmuese në menaxhimin e rasteve dhe ofrimin e shërbimeve krahasuar me procesin e vlerësimit të riskut.
- Nga monitorimi nuk ka rezultuar dërgimi nga policia i kopjeve të UMPMM tek KVDHF. Në rastet kur është prezent në vlerësimin e riskut, KVDHF merr kopjen e UMPMM.
- Numri i PMF në Bashkinë Durrës nuk është në respektim të ligjit nr. 18/2017 *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*, i cili kërkon që numri i PMF ti përgjigjet numrit të fëmijëve (një PMF për 3000 fëmijë).
- PMF rezulton se nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e riskut kur viktimat ka fëmijë të mitur, me arsyetimin se fëmijët janë me njërin nga prindërit.
- Efektet e tërmetit dhe pandemisë kanë sjellë efekte në efektivitetin e punës së Mekanizmit të Koordinuar të rasteve të dhunës në familje. Kjo sfidë rezulton edhe në raportet monitoruese të Qendrës Aleanca Gjimore për Zhvillim GADC⁸.
- Një nga punonjëset e intervistuar shprehet se ndryshimi i banesës, ndryshimi i numrave të telefonit të viktimës, ngarkesa e punës, pandemia dhe tërmeti janë disa nga rrethanat që kanë vështirësuar përgatitjen e raportit të monitorimit.

⁸https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Raporti%20Final%20i%20Perbashket_Unë_COVID-19.pdf

- Mungesa e programeve të rehabilitimit për burra dhe djem përbën një nga sfidat e MKR pranë Bashkisë Durrës.
- Lëvizjet e specialistëve të policimit në komunitet kanë sjellë efekte në bashkëpunimin e policisë me Koordinatorin Vendore Kundër Dhunës në Familje dhe Specialistes kundër dhunës në familje⁹.

SHKODËR

Policia e shtetit

- Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për policinë në lidhje me aspekte praktike të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- Kanë rezultuar vështirësi me viktimat e dhunës në familje, të cilat nuk pranojnë të bëjnë kallëzim, nuk pranojnë as edhe t’u plotësohen kërkesat për urdhër mbrojtje, edhe pasi janë informuar për të drejtat e tyre për mbrojtje nga dhuna në familje.
- Pesha e përgatitjes së kërkesave për urdhra të menjëhershëm mbrojtje dhe urdhra mbrojtje i ka rënë vetëm policisë, ndërkohë që ligji parashikon edhe subjekte të tjera që mund të mbështesin përgatitjen e kërkesave për urdhra mbrojtje.
- Mungesa e strukturave për akomodimin e dhunuesit është një nga sfidat me të cilat përballen punonjësit e policisë dhe kjo ka vështirësuar lëshimin e UMPMM si dhe marrjen e masës së largimit të dhunuesit nga banesa.
- Edhe punonjësit e policisë në Shkodër shprehen se është sfiduese ngarkesa e tyre dhe koha e shkurtër që kanë në dispozicion për trajtimin e një rasti dhune, për shkak të ngarkesës së punës. Një nga punonjësit e policisë i intervistuar shprehet se, *ka pasur raste kur kanë pasur 5 konflikte të dhunës në familje brenda 30 minutave.*
- Mungon mbështetja e mjaftueshme në lidhje me aspekte logjistike si transport, mjete, ushqim, ujë, akomodim në hotel për viktimën e dhunës në familje dhe fëmijët. Mungojnë ambiente të përshtatshme për intervistimin e viktimës së dhunës në familje. Edhe mungesa e zyrave për SPZ-të dhe qëndrimi i 32 SPZ në një zyrë përbën një sfidë.

Bashkia

- Mungesa në burime njerëzore dhe konkretisht e një KVDHF në këtë bashki, pavarësisht se në mungesë të KVDHF janë angazhuar specialistet e sektorit, përgjegjësjë e sektorit dhe qendrat komunitare

⁹ Nga intervista me Specialistin kundër dhunës në familje në NJA Sukth.

V. REKOMANDIME

1. Në lidhje me zbatimin e legjislacionit kundër dhunës në familje:

- Është e nevojshme njohja më e mirë e legjislacionit, në mënyrë të veçantë e ligjit nr. 47/2018, si dhe e akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Edukimi i ligjit për aktorët e sistemeve duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i rregullt, veçanërisht po të marrim parasysh transferimet dhe ndryshimet e stafit.
- Për këtë rekomandojmë që Kuvendi dhe organet e tjera të marrin masa për njohjen më të mirë të projektligjeve dhe të përmbushjes së planeve të trajnimit të personave përgjegjës edhe përpara se akti të hyjë në fuqi. Për reformat e ardhshme ligjore, Kuvendi duhet të marrë parasysh angazhimin mw tw madh tw palëve të interesuara, të përbërë nga aktorë multidisiplinarë dhe shoqëri civile, para hyrjes në fuqi të ligjit, për të planifikuar zbatimin e ligjit dhe për të siguruar që Shqipëria dhe qytetet lokale të kenë një përgjigje efektive, sistemike ndaj dhunës në familje.
- Të vijojë marrja e masave nga organet vendore për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.327, dt. 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

2. Në lidhje me veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Të vijojë trajnimet e stafit, në mënyrë të veçantë SPZ të rinj për njohjen më të mirë të ligjit nr. 47/2018, si dhe akteve ligjore për zbatimin e tij, si Udhëzim i përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, Udhëzim i përbashkët nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”, Vendimi nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”, etj. Trajnime të tilla duhet të drejtohen ose të bëhen në konsultim me OJQ -të që i kuptojnë më mirë nevojat e viktimave.

Të vijojë forcimin e strukturave të specializuara kundër dhunës në familje pranë policisë së Shtetit, duke rritur numrin e SPZ dhe përbërjen e grave dhe vajzave.

Të marrë të gjitha masat e nevojshme që vlerësimi i riskut të kryhet në çdo rast të raportimit të dhunës në familje, duke vlerësuar faktorët e parashikuar në Udhëzimin e përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”. Në rastet kur një vlerësim rreziku nuk kryhet, tregoni në dokumentacion arsyet dhe veprimet e ndërmarra për të arritur në vendimin për të anashkaluar një vlerësim rreziku.

Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të bashkëpunuar me KVDHF dhe PMF për vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e rastit të dhunës në familje;

Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të bashkëpunuar në mekanizmin e referimit kundër dhunës në familje për çdo rast dhune në familje.

Të lëshojë UMPMM sa herë që konstaton risk imediat nga vlerësimi i riskut. Të minimizojë kërkesat e drejtpërdrejta në gjykatë për UMM, të cilat duhet t’i kërkojë pasi ka lëshuar vetë UMPMM. Në rastet e riskut të ulët dhe jo imediat mund të kërkojë drejtpërdrejtë në gjykatë UM.

Të unifikojë dhe përmirësojë praktikën e vlerësimit të riskut, lëshimit të UMPMM dhe menaxhimit të rastit të dhunës, mbi bazën e ndryshimeve ligjore nr. 47/2018.

Të adresojë të gjitha sfidat me karakter teknik që pengojnë vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e rastit të dhunës në familje, duke siguruar burimet njerëzore të nevojshme, të kualifikuara, që kanë qëndrueshmëri në funksion, si dhe kushtet e rëndësishme teknike, zyra, materiale, aparatura kompjuterike, etj.

3. Në lidhje me veprimtarinë e organeve vendore;

Të sigurohet emërimi i koordinatorëve vendorë në bazë të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Të emërohet KVDHF në bashkinë Shkodër, pa vonesw. Të mundësohet emërimi i më shumë se një koordinatorëve vendor mbi bazën e standardeve të miraturara nga Këshilli i Ministrave për MKR-të.

Të shmangen mbivendosjet e detyrave dhe funksioneve për KVDHF, i cili është me kohë të plotë dhe i dedikuar për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Pozicioni i KVDHF të jetë i ndarë nga pozicioni i Specialistes së Barazisë gjinore apo pozicione të tjera.

Të verësohen mundësi të tjera për bashkëpunimin me policinë e Shtetit për vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e rastit të dhunës në familje, veçanërisht përmes aktivizmit të KVDHF dhe të grupit Teknik ndërdisiplinor të mekanizmit vendor të referimit. Duhet të eksplorojnë takime të rregullta të vazhdueshme me policinë dhe aktorët e tjerë të sistemeve të përfshirë në reagimin ndaj dhunës në familje, me qëllim vlerësimin e sfidave sistematike në ligj me synimin drejt reformave të vazhdueshme.

Të trajnohen burimet njerëzore që operojnë në këtë fushë për njohjen e legjislacionit kundër dhunës në familje, in consultation with with NGOs serving victims of domestic violence.

Të forcohet bashkëpunimi i koordinatorit vendor KVDHF me policinë e shtetit për vlerësimin e riskut. Wshtw i nevojshëm zhvillimi i një sistemi për t'u siguruar që ata të njoftohen nga policia kur kjo përgjigjet gjatë natës apo fundjavave.

Të forcohet bashkëpunimi i koordinatorit vendor KVDHF me policinë e shtetit për menaxhimin e rastit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Të rritet roli i KVDHF për koordinimin e ETN-së.

Të rritet roli i KVDHF për monitorimin e zbatimit të UM. Bashkëpunimi me policinë gjatë monitorimit të zbatimit të UM është i rëndësishëm. Të përgatiten raportet e monitorimit për rastet e dhunës në familje të pajisur me urdhra mbrojtje në fuqi si dhe të dërgohen ato pranë policisë, duke respektuar afatin. Kur kur ka informacione për shkelje të masave mbrojtëse, KVDHF të njoftojë policinë menjëherë.

Të zgjerohen shërbimet dhe forcohen burimet njerëzore dhe të tjera në çdo njësi administrative me qëllim parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në këtë nivel.

Të forcohen qendrat komunitare me qëllim parandalimin e rasteve të dhunës në familje dhe ofrimin e shërbimeve apo programeve të ndryshme.

4. Në lidhje me sfidat teknike.

Të krijohen ambiente të përshtatshme në polici për pritjen dhe intervistimin e viktimave të dhunës në familje dhe/ose fëmijëve të tyre apo të shoqëruesve të tyre, duke e vendosur viktimwn nw qendwr. Krijimi i një ambjenti miqësor gjatë intervistimit të viktimës së dhunës në familje është shumë i rëndësishëm me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm për kryerjen e vlerësimit të riskut.

Të forcohet mbështetja logjistike dhe SPZ e Ndihmës SPZ që merren me dhunën në familje ta kenë një zyrë dhe të pajisen me kompjuter, printer për përgatitjen e dokumenteve të praktikës së plotë të rasteve të dhunës në familje.

Të kenë akses në mjete transporti dhe karburant, etj., që lehtësojnë punën e policisë dhe KVDHF në zbatim të ligjit.

5. Të tjera

Të organizohen trajnime të kombinuara nw konsultim me organizatat qw ofrojnë shërbime për viktimat, me pjesëmarrjen e policisë dhe KVDHF si dhe anëtarë të tjerë të ETN-së së MKR në mënyrë të vazhdueshme, sidomos kur miratohen ndryshime ligjore që efektojnë punën e tyre.

Rekomandohet ngritja e strukturave të akomodimit për dhunuesit, me qëllim monitorimin më të mirë të rastit dhe rritjen e sigurisë për viktimat, duke minimizuar përsëritjen e incidenteve të dhunës ndaj viktimës apo të tjera. Ne mendojmë se, struktura të tilla akomodimi nuk duhet të devijojnë fondet e nevojshme për shërbimet e viktimave. Për këtë propozojmë që dhunuesit në pamundësi, të sistemohen në qendra sociale ekzistuese.

Të organizohen trajnime gjatë punës “on job”, gjatë të cilave trajneri të qëndrojnë pranë policisë gjatë kohës që punojnë, të ndjekë rastin konkret dhe të udhëzojë punonjësën e policisë si duhet të veprojnë.

Një Punonjës social apo KVDHF të qëndrojnë në ambjentet e policisë, në mënyrë që të kontribuojnë në procesin e vlerësimit të riskut pa vonesë.

Të mbështetet me mjete financiare ngritja e programeve për dhunuesit, ku të përfshihet edhe ngritja e strukturave të akomodimit për dhunuesit që urdhërohen të largohen nga banesa me urdhrin administrativ të policisë apo urdhrin e gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes apo Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Programet e tilla duhet të jenë në përputhje me standardet e praktikave më të mira¹⁰.

Të promovohen punonjësit model në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe të merren masa në rastet e shkeljes së detyrimeve me të cilat i ngarkon ligji.

¹⁰ See <https://www.theadvocatesforhumanrights.org/Publications/Index?id=195> for a description of best practice standards for perpetrator treatment programs.

Anex 1. SKEDA E MONITORIMIT

MBI ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE TË LIGJIT NR.9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, I NDRYSHUAR, NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E RISKUT DHE LËSHIMIN E UMPMM.

Periudha e monitorimit: Janar 2019-Dhjetor 2020

Prezantim: Unë quhem nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Qendra për Nisma Ligjore është një organizatë jo fitimprurëse në Shqipëri që ofron ndihmë ligjore falas dhe kontribuon për rritjen e aksesit të qytetarëve, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave të varfra dhe të dhunuara në sistemin e drejtësisë. Ne po punojmë për të përgatitur një raport monitorimi mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, në lidhje me vlerësimin e riskut dhe lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM) nga policia në rastet kur rezultojnë risk për jetën e viktimave të dhunës në familje. Ne po kryejmë intervista me punonjës të policisë dhe Koordinatorë vendore kundër dhunës në familje (KVDHF), si dhe po analizojmë raporte të vlerësimit të riskut, Urdhra për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM), vendime të Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhrave të Mbrojtjes (UM) të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shkodër dhe Durrës. Ne synojmë të publikojmë një raport me rekomandime bazuar në gjetjet e monitorimit.

Ju falenderojmë për kohën tuaj dhe kemi disa pyetje në lidhje me zbatimin e ligjit nga ana juaj dhe përvojat tuaja për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme. Të gjitha intervistat tona do të mbeten konfidenciale dhe nuk do të publikojmë emrin tuaj. (Ky rregull nuk zbatohet nëse jeni zyrtar i nivelit të lartë. Për zyrtarët e nivelit të lartë: për shkak të natyrës së punës suaj, ju do të citoheni së bashku me pozicionin tuaj).

A keni ndonjë pyetje para se të fillojmë?

I. INTERVISTË ME PUNONJËS TË POLICISË

Monitoruesit do të vlerësojnë si më poshtë:

Cili është roli juaj? Përshkruani punën tuaj.

a) Sa raste ka trajtuar Policia e Shtetit në periudhën objekt monitorimi? ____

b) Ne sa raste Policia e Shtetit ka kryer vlerësimin e riskut? ____

- c) Në sa raste Policia e Shtetit ka lëshuar UMPMM? ___
- d) Në sa raste Policia e Shtetit ka kërkuar UMM drejtpërdrejtë në gjykatë? ___
- e) Në sa raste Policia e Shtetit ka kërkuar UM drejtpërdrejtë në gjykatë? ___
- f) Në sa raste Policia e Shtetit e ka kaluar drejtpërdrejtë çështjen për përgjegjësi penale? _

3) A është kryer vlerësimi i riskut për çdo rast dhune në familje të raportuar në komisariatit e policisë?

- a)Po
- b)Jo

Kur vendosni të kryeni një vlerësim risku? Përshkruani cilët faktorë merrni në konsideratë për të vendosur nëse do të kryeni vlerësim risku?

- a) Kush e merr vendimin nëse do të kryeni vlerësimin e riskut?
- b) Cili është afati për të kryer vlerësimin e riskut, nisur nga njoftimi fillestar i rastit të dhunës në familje?
- c)A ka ndonjë rrethanë ku ju vendosni të mos kryeni vlerësimin e riskut? Cilat janë shkaqet pse ju nuk e kryeni vlerësimin e riskut? (Kërko një shembull)
- d)Çfarë vendosni nëse viktimi nuk dëshiron një Urdhër për Masat Paraprake të mbrojtjes së Menjëhershme?

4) A mund të përshkruani procesin për njoftimin e Koordinatorës Vendore Kundër Dhunës në familje pranë njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore?

- a. A ka raste që oficeri i policisë nuk njofton Koordinatorën vendore kundër dhunës në familje? Për çfarë arsyeje nuk do ta njoftonte? Përshkruani. {Shënim: Jepni një rast konkret si shembull nëse është e mundur}
- b. Sa kohë i nevojitet policisë për të njoftuar Koordinatorën vendore kundër dhunës në familje? Sa kohë kohë nevojitet zakonisht që koordinatori vendore kundër dhunës në familje, të përgjigjet?

5) A mund të përshkruani procesin e njoftimit të Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, kur një i/e mitur është përballur me dhunë në familje?

- a. A ka raste kur një punonjës policie nuk njofton Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve? Për çfarë arsyeje nuk do ta njoftonte? Përshkruaj shkurtimisht.
- b. Sa kohë i nevojitet policisë të njoftojë Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki /

punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve? Sa kohë nevojitet zakonisht që Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, të përgjigjet?

6) Çfarë roli luan Koordinatori Vendor Kundër Dhunës në Familje ose punonjësi social në kryerjen e vlerësimit të riskut? Si punon KVDHF ose punonjësi social me policinë gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut?

- a. Çfarë ka ndodhur kur KVDHF ose punonjësi social nuk është përgjigjur?
- b. A ndodhin shpesh rastet e mos paraqitjes së tyre? Shpjegoni. {Shënim: Merrni një shembull konkret}

7) Në sa përqind të të gjitha rasteve të dhunës në familje ju lëshoni Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme?

- a. Në rastet kur ju nuk lëshoni Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme , cilat janë arsytet pse nuk e lëshoni? {Shënim: Jepni një shembull konkret rasti}

8) Unë dëshiroj të diskutojmë rreth procesit të lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

- a. Çfarë funksionon mirë në procesin për lëshimin dhe zbatimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme?
- b. Cilat janë disa nga sfidat në lidhje me procesin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme? Çfarë nevojitet për t'i kapërcyer këto sfida? A mund të jepni një shembull konkret?

c. Ligji kundër dhunës në familje ka parashikuar masa të ndryshme për mbrojtjen nga dhuna në familje..

-Cilat janë masat që përdoren më shpesh në Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme?

-Cila masë është më pak e përdorur në Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme? Pse mendoni se ndodh kjo? {Merrni kopje të të dhënave nëse është e mundshme}

d. A e merrni pëlqimin e viktimës së dhunës në familje kur vendosni se cilat masa të përfshini në Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme?

9) Përshkruani si policia e zbaton Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme?

10) A bashkëpunon policia me KVDHF në zbatim të UMPMM? Përshkruani. A keni një shembull konkret për të ndarë?

11) A informon policia viktimat dhe dhunuesit në lidhje me masat e marra në UMPMM?

Si e kryejnë këtë informim?

- Çfarë afati kanë për të njoftuar dhunuesin/en ose viktimën?
- Çfarë ndodh me Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme nëse policia e ka të pamundur të informojë dhunuesin?
- A keni pasur ndonjëherë një rast ku dhunuesi ka përsëritur dhunën para se policia ta informonte në lidhje me UMPMM? Cfarë ka ndodhur?

12. Nëse viktima ka tashmë një urdher mbrojtje, si e ndikon kjo vendimin tuaj për ta referuar rastin për ndjekje penale?

- A ka raste kur ju nuk keni bërë dhe bëni referim për ndjekje penale? Pse? A mbani ju të dhëna për rastet e referuara dhe rastet që nuk janë referuar për ndjekje penale?

13. Në raportin tonë, ne do të bëjmë rekomandime për qeverinë. A keni ndonjë rekomandim që ne mund ta përfshijmë në lidhje me ligjin, vlerësimin e riskut, Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme ose procesin në tërësi?

14. A ka punonjës të tjerë që ju mendoni se ne duhet t'i intervistojmë?

II. MONITORIMI I RAPORTEVE TË VLERËSIMIT TË RISKUT DHE UMPMM

(Ky seksion do të përdoret nëse monitoruesit do të lejohen për të shqyrtuar raporte vlerësimi risku dhe Urdhra për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme)

1) A është përdorur forma e vlerësimit “Raport për vlerësimin e riskut për rastin e dhunës në familje”, sipas aneksit të “UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 866, datë 20.12.2018 PËR PROCEDURAT DHE MODELIN E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE” nga policia?

a) Po b)Jo

2) A është asistuar policia nga KVDHF në vlerësimin e riskut?

3) Nëse KVDHF ka qenë në pamundësi për të asistuar në vlerësimin e riskut, a është zëvendësuar menjëherë nga një punonjës social i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore?

a)Po b)Jo

4)A ka asistuar NJMF/PMF policinë në hartimin e raportit të vlerësimit të riskut?

a) Po b) Jo

a)Po b)Jo

5) A rezulton nga monitorimi se punonjësi i policisë i ngarkuar të kryejë vlerësimin e riskut ka kërkuar informacion nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit të vendbanimit të viktimës, nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit?

a)Po b)Jo

6) A rezulton nga monitorimi se raporti i vlerësimit të riskut ka shprehur qartë nivelin e rrezikut për rastin konkret dhe ka sugjeruar masa mbrojtëse në proporcion me të?

a)Po b)Jo

7) Cilat janë burimet e informacionit të përdorura nga Policia në vlerësimin e riskut?

- a)informacioni që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës?
- b)informacionin që mund të mblidhet menjëherë nga pyetja e të dhunuarës?
- c)informacioni që mund të mblidhet nga pyetja e dhunuesit?
- d)informacioni që mund të mblidhet nga pyetja e anëtarëve të tjerë të familjes?
- e)informacioni që mund të mblidhet nga institucionet?
- f)informacioni që mund të mblidhet nga organizatat që kanë dijeni për rastin?
- g)informacioni që mund të mblidhet nga individët që kanë dijeni për rastin?

8) A përmban raporti i vlerësimit drejtuar titullarit të strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, apo punonjësit të autorizuar prej tij, sugjerimet si vijojnë?

1. miratimin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nëse është rasti;

a)Po b)Jo

2.marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, që duhet të urdhërohen në UMPMM për ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës, duke u bazuar në parimin e parandalimit të

përshkallëzimit të dhunës dhe të proporcionalitetit me nivelin e rrezikut të dhunës, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si edhe shmangien e lënies së fëmijëve pranë dhunuesit;

a)Po b)Jo

3.vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence, e cila sugjerohet vetëm kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut për jetën e saj, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve të mitur për të mos qëndruar me dhunuesin/en në mënyrë të pambikëqyrur, vullnetin e viktimës për t'u strehuar, si dhe legjislacionin në fuqi për standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra;

a)Po b)Jo

4.vendosjen e viktimës pranë qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale;

a)Po b)Jo

5.zbatimin e UMPMM-së, në rastin e dhunës së ushtruar drejtpërdrejt mbi fëmijët në qasje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve, nën përgjegjësinë e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve;

a)Po b)Jo

6.marrjen edhe të masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme për menaxhimin e riskut dhe zbatimin e UMPMM-së, të cilat koordinohen me institucionet përkatëse nga koordinatori vendor dhe Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje;

a)Po b)Jo

9)A është i qartë punonjësi i policisë dhe ka marrë veprimet e nevojshme në përputhje me faktin që lëshimi i UMPMM-së nuk pengon ndjekjen penale të dhunuesit?

a)Po b)Jo

10) A është respektuar afati i dërgimit të UMPMM për konfirmim në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe lëshimin e UMM?

a) PO b)Jo

11) Cilat masa mbrojtëse janë përfshirë në UMPMM?

a) urdhërimi i dhunuesin/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktima, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

e) urdhërimin për largimin e i menjëhershëm të dhunuesit/es nga banesa kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë ,derisa gjykata të nxjerre urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara

12) Shënime të tjera

III. Monitorimi i Raporteve të Vlerësimit të riskut dhe Urdhrave për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

Shënim: Pyetjet e mëposhtme plotësohen vetëm nëse do të mund të kryejmë intervista me KVDHF dhe policinë për këtë seksion “Nga Monitorimi i Raporteve të Vlerësimit të riskut dhe Urdhrave për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”, përveç monitorimit të raporteve të vlerësimit të riskut dhe UMPMM.

1. A është përdorur forma e “Raport për vlerësimin e riskut për rastin e dhunës në familje”, sipas aneksit të “UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 866, datë 20.12.2018 PËR PROCEDURAT DHE MODELIN E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE”?

a. Po b. Jo

2. A mbështeti KVDHF policinë gjatë procesit të vlerësimit të riskut? Si?

a. Si ka shkuar ky bashkëpunim?

3. Nëse KVDHF nuk mundi të asistonte në procesin e vlerësimit të riskut, cilat ishin arsye të mungesës së saj ?

a. Sa kohë zëvendësimi i KVDHF me një punonjës social? b. Shpjegoni si funksionon procesi. A flet në mënyrë të drejtëpërdrejtë KVDHF me viktimën? A merr KVDHF një raport nga

policia?

4. A e asiston NJMF/PMF policinë në procesin e vlerësimit të riskut për fëmijët? Përshkruani.

a. Si ka shkuar ky bashkëpunim?

5. Cila është procedura nëse vendqëndrimi i viktimës është i ndryshëm nga vendbanimi i saj/tij? A funksionon mirë kjo procedurë? Jepni argumente pse funksionon ose pse nuk funksionon.

6. A përcaktoni qartë në raportin e vlerësimit të riskut shkallën e riskut?

a. A mendoni se masat mbrojtëse të sugjeruara janë proporcionale me riskun? Pse po, pse jo? {Shënim: Jepni një shembull konkret}.

b. A ka pasur ndonjë rast ku ju keni menduar se masat nuk ishin proporcionale me nivelin e riskut? {Shënim: Jepni një shembull konkret}.

7. Cilat burime informacioni përdorni për të kryer vlerësimin e riskut?

a. Cilat institucione ose organizata kontaktoni? Kur?

b. Si e mblidhni informacionin nga viktimat? Si e mblidhni informacionin nga dhunuesit? {Shënim: identifikoni nëse ata e veçojnë viktimën nga dhunuesi gjatë vlerësimit të riskut}

8. Sa shpesh/në përqindje të rasteve, raporti i vlerësimit kërkon masa mbrojtëse në UMPMM?

9. A ka pasur raste kur lëshimi i UMPMM ka ndaluar ndjekjen penale? Nëse po, përshkruani

a. Çfarë veprimesh duhet të ndërmerret oficeri i policisë për të siguruar që UMPMM nuk e ndalonte ose ndalon ndjekjen penale të dhunuesit?

b. A keni raste ku UMPMM ka ndaluar ndjekjen penale? Në këto raste, a kreu akte dhune përsëri dhunuesi?

10. A ka raste ku nuk janë përmbushur afatet e UMPMM? Çfarë ka ndodhur? A përsëriti dhunuesi dhunën gjatë kësaj kohe?

a. Nëse policia e humbet afatin e 48 orëve, a lëshon gjykata UMM? Nëse jo, a keni dëgjuar ndonjëherë për raste ku viktimat janë dëmtuar?

b. Nëse ka vonesa, cila është vonesa më e madhe që ju keni dëgjuar? Përshkruani çfarë ndodhi.

11. A është ndonjë nga këto masa që ju mendoni se duhet të përdoren si opsion i fundit? Pse? Kur do ti përdornit ju këto masa?

12. A janë masat mbrojtëse në UMPMM adekuate/ të duhurat për mbrojtjen e viktimës? Pse ose pse jo?

- a. A ka masa të tjera mbrojtëse që ju mendoni se duhet të përfshiheshin në këto masa?
- b. A keni parë dhunues që kryejnë veprime të cilat nuk mund të mbulohen nga këto masa? Përshtkruaj. Jepni një shembull konkret.

IV. INTERVISTË ME KVDHF

Ju lutem përshtkruani pozicionin tuaj të punës dhe punën që ju kryeni. Ju lutem përshtkruani si ju ndërveproni me policinë dhe të tjerët kur kryhet vlerësimi i riskut të rastit të dhunës në familje.

1) A ka kontaktuar policia KVDHF për kryerjen në çdo rast të vlerësimit të riskut?

- a)Po
- b)Jo

2) Në 2020, sa herë KVDHF është njoftuar të asistojë në një vlerësim risku?

3) A ka asistuar KVDHF në vlerësimin e riskut gjatë vitit të fundit?

- a)Po
- b)Jo

a. Nëse KVDHF nuk asistoi në vlerësimin e riskut, cilat ishin arsyet?

Përshtkruani si funksionon procesi kur policia kontakton KVDHF për kryerjen e vlerësimit të riskut.

b. A flet KVDHF direkt me viktimën, apo e merr informacionin nga policia?

c. A ofron ndihmë KVDHF për policinë në lidhje nivelin e riskut? Nëse po, sa policia i merr në konsideratë vlerësimet e dhëna nga KVDHF?

d. Çfarë funksionon mirë në lidhje me bashkëpunimin KVDHF-polici? Çfarë nuk funksionon mirë në këtë bashkëpunim?

e. A keni sugjerime për përmirësimin e procesit?

4) Sa UMPMM ju kanë ardhur nga policia gjatë vitit 2019? _____gjatë vitit 2020?

5) Cilat masa zakonisht parashikon policia në UMPMM?

a. Cilat janë masat që urdhërohen më pak? A ka masa që policia i përdor vetëm si opsion i fundit? Cilat janë arsyet që policia nuk i urdhëron këto masa “opsion i fundit”?

b. A janë masat ekzistuese të duhurat/adekuate për mbrojtjen e viktimave? Pse po, pse jo?

A ka masa të tjera që ju mendoni se duhet të përfshihen në UMPMM, të cilat nuk janë parashikuar aktualisht?

c. A keni parë raste të dhunuesve që kanë kryer veprime/sjellje që nuk mbulohen nga këto masa? {Shënim: Jepni një shembull konkret}

6) Sa UMM ju kanë ardhur nga gjykata për vitin 2019 dhe 2020? _____; _____:

Sa UM ju kanë ardhur nga gjykata për vitin 2019 dhe 2020? _____; _____:

(Kërkohet informacion vetëm për UMM që janë lëshuar nga vleftësimi i UMPMM dhe UM që kanë ardhur nga vërtetimi i UMM të mësipërme).

a. Nëse gjykata nuk lëshoi një UMM ose UM, cila ishte arsyeja? {Shënim: Jepni një shembull konkret}

7) A ka monitoruar Zyra e shërbimeve sociale respektimin e UMM/UM nga palët?

a)Po b)Jo

a. Përshkruani si Zyra e Shërbimeve Sociale monitoron këtë respektim. Në opinionin tuaj, si funksionon kjo?

b. A punon KVDHF së bashku me Zyrën e Shërbimeve Sociale mbi vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM? Përshkruani.

c. A jeni në gjendje të regjistroni shqetësimet në lidhje me procesin ose rezultatet në lidhje me Zyrën e Shërbimeve Sociale ose një tjetër institucion shtetëror? Përshkruani.

8) A ka përgatitur KVDHF çdo 60 ditë një raport monitorimi?

a)Po b)Jo

a. Përshkruani monitorimin e KVDHF. Mbi cilat burime informacioni mbështetet KVDHF për të përgatitur raportin e monitorimit?

b. Çfarë ndodh nëse KVDHF beson se nevojiten të kryhen disa ndryshime në rastet e monitoruara?

c. A ka ndonjë rrethanë ku ju nuk jeni në gjendje të plotësoni raportin çdo 60 ditë? Në çdo rast ku KVDHF nuk ka përgatitur raportin e monitorimit, pse ka ndodhur? A keni një shembull konkret? {Ndiqe më tej për të parë nëse viktimat është dëmtuar përsëri}

9) A ka vënë në dijeni KVDHF policinë për raportin e monitorimit?

- a) Po b) Jo

10) Përshkruani bashkëpunimin e KVDHF-së me policinë në monitorimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje të pajisur me urdhra mbrojtje.

- a. A rekomandoni ndryshime në lidhje me këtë bashkëpunim midis KVDHF dhe policisë?
 b. Me cilat institucione/OJF/organizata bashkëpunon KVDHF për monitorimin e UMPMM?

11) Sa raporte monitorimi ka dërguar KVDHF pranë policisë për vitin 2020? _____

12) Cilat janë disa nga masat e marra në zbatim të UMPMM nga KVDHF?

A mund të jepni një shembull konkret?

V. MONITORIMI I UMM/UM.

(Do të monitorohen vetëm UMM që vijnë nga vleftësimi i UMPMM-së, si dhe UM që kanë ardhur nga vërtetimi i UMM-së).

Monitorimi i urdhrave do të kryhet duke regjistruar emrin dhe mbiemrin e viktimës, me qëllim që të mos ketë mbivendosje.

- 1) Çfarë provash kërkon gjykata për të vendosur të lëshojë UMM?
 - 2) A vlerëson gjykata Raportin për vlerësimin e riskut, kur shqyrton kërkesën për lëshimin e UMM-së dhe UM-së?
 - 3) A merr gjykata të dhëna të tjera nga policia, KVDHF ose NJMF/PMF në lidhje me nivelin e riskut dhe masat mbrojtëse që duhet të përfshihen në urdhër?
- 4) A rezulton nga vendimi se është kryer vlerësimi i riskut për rastin?

- a) Po b) Jo

5) A rezulton info për nivelin e riskut?

a. A përfshihet informacioni në lidhje me nivelin e riskut, në vendim? Po/Jo.

6) Cili është niveli i riskut që gjendet më shpesh?

a) i lartë b) i mesëm c) i ulët

7) A rezulton informacion nëse policia është asistuar nga KVDHF/punonjësi?

a) Po b) Jo

8) A rezulton informacion nëse policia është asistuar nga PMF-ja/punonjësi?

a) Po b) Jo

9) A rezulton nga vendimi se është lëshuar UMPMM?

a) Po b) Jo

10) Cilat masa ka parashikuar policia në UMPMM?

a) urdhërimi i dhunuesin/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

e) urdhërimin për largimin e i menjëhershëm të dhunuesit/es nga banesa kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë ,derisa gjykata të nxjerre urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara

11) Cilat janë masat që gjykata ka parashikuar në UMM dhe UM?

a. Cila është zgjatja tipike e një UMM/UM? A janë ato proporcionale me nivelin e riskut?

12) Sa shpesh gjykatat ndryshojnë masat e urdhëruara në UMPMM? Nëse po, a shtojnë ose heqin gjykatat, masat e parashikuara në UMPMM? Jepni një shembull.

Skeda e Monitorimit është përgatitur nga ekspertët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe ekspertët e organizatës “The Advocates for Human Rights”, në kuadrin e projektit “Të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të përgjigjes ndaj dhunës në familje”, financuar nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë.

Përmbajtja dhe opinionet e këtij materiali janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.